

FONDACIONI INSTITUTI SHOQËRIA E HAPUR - MAQEDONI
QENDRA MAQEDONASE PËR ARSIM EVROPIAN

GJITHÇKA QË KENI

DASHUR TË DINI PËR BE

Shkup, prill 2009

GJITHÇKA QË KENI DASHUR TË DINI PËR BASHKIMIN EVROPIAN

Boton:

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Milçin, Drejtor ekzekutiv

Autorë:

Qendra maqedonase për arsim evropian

Përkthimi:

ABAKUS

Formësimi artistik-grafik:

Brigada Dizajn

Shtyp:

Skenpoint

Tirazhi: 4200 copë

Republika e Maqedonisë e fitoi statusin e shtetit-kandidat në vitin 2005 - kaluan pesë vite që nga kjo datë, por shteti edhe më tej nuk i ka filluar bisedat për anëtarësim.

Projekti "Aksioni për Evropë" ka për qëllim të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e përsheptimit të procesit të aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Projekti planifikohet si një serial i ngjarjeve për promovimin e Bashkimit Evropian dhe përfitimet e Republikës së Maqedonisë nga anëtarësimi në BE, përfshirë edhe debatet për sfidat e Republikës së Maqedonisë në rrugën drejt BE-së. Projekti ka filluar në vitin 2009 dhe ka vazhduar në komunat tjera gjatë vitit 2010. Kjo broshurë duhet t'i sigurojë qytetarëve informata themelore për programet e bashkësive dhe domethënien e tyre, t'i përgatisë për marrjen e informatave për programet në Maqedoni dhe të kuptojnë si duhet të duket një projekti i suksesshëm që do të finançohej përmes programit gjegjës të bashkësive. Presim që broshura ta rrisë presionin dhe përkushtimin e qytetarëve mbi të gjithë pjesëmarrësit e aderimit të Republikës së Maqedonisë në BE, për plotësimin e rekomandimeve kyçe të Partneritetit për anëtarësim dhe të sigurojë rekomandim për fillimin e negociatave për anëtarësim, përmes Raportit për progresin e vitit 2009 nga Komisioni Evropian.

Broshura realizohet si pjesë e aktiviteteve në kuadër të projektit "Aksioni për Evropë", që realizohet nga Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni, në bashkëpunim me Qendrën maqedonase për arsim evropian, Forumin rinor arsimor, Qendrën rinore kulturore nga Manastiri dhe 12 qendrat e burimit për përkrahjen e organizatave joqeveritare¹, që funksionojnë në 12 komuna² në Maqedoni.

1 Fondacioni për zhvillimin e bashkësisë lokale - Shtip, Fondacioni për zhvillim lokal dhe demokraci Fokus - Veles, Qendra për përkrahje dhe zhvillim - Prilep, Qendra për përkrahjen e bashkësive - Kërçovë, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta - Strumicë, Qendra për përkrahjen e bashkësive - Resnjë, Qendra për zhvillimin e qëndrueshëm të bashkësive - Dibër, Qendra rajonale për përfaqësim - Dellçevë, Qendra për zhvillim rajonal Antigonea - Negotinë, Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm - Kratovë, Akua - Strugë, QKR - Manastir dhe Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm - Gjevgjeli

2 Kratova, Dellçeva, Strumica, Gjevgjelia, Negotina, Shtipi, Velesi, Prilepi, Kërçova, Dibra, Struga, Resnja



The following text is a placeholder for the main content of the page, which is currently blank.

SI TË ARRIHET ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN?

1 A është aderimi në Bashkimin Evropian çështje e vendimit politik?

Jo. Vendimi merret nga politikanët, por assesi nuk është vendim politik. Në të kaluarën, kanë ekzistuar shembuj kur pranimi i ndonjë shteti-anëtar ka qenë çështje e vendimit politik. Për shembull, pa dallim faktit që Mbretëria e Bashkuar e ka kërkuar anëtarësim në BE në vitet '60, Franca dy herë e ka bllokuar pranimin, kështu që shteti është anëtarësuar në BE në vitin 1973, pesë vite pas ndërrimit të Charles de Gaulit dhe pas zgjedhjes së Ziskar d'Estenit për Kryetar të Francës.

Vendimi i fundit politik për pranimin e shtetit të ri anëtar në BE është miratuar në vitin 1981, kur pa dallim nga mendimi negativ i Komisionit Evropian, Këshilli i Ministrave ka vendosur për pranimin e Republikës së Greqisë. BE preket edhe sot nga ky vendim, jo vetëm për shkak të kontestit të emrit me Republikën e Maqedonisë, por edhe në pjesën e zbatimit të legjislacionit evropian. Prej këtij momenti, BE ka vendosur që asnjëherë të mos e bazojë pranimin e ndonjë vendi vetëm në bazë të vendimit politik. Për këtë arsye janë përcaktuar të a.q. Kriteret e Kopenhagës.

2 Si vlerëson BE-ja që ndonjë vend është përgatitur për tu bërë anëtar?

Në fund të viteve '80, me ndryshimin e sistemeve politike në vendet e Evropës së mesme dhe lindore dhe kërkesës së tyre për anëtarësim, BE i ka përcaktuar kriteret me të cilat vlerësohet gatishmëria për anëtarësim në BE.

Kriteret janë përcaktuar nga Samiti (mbledhja e Këshillit Evropian) në Kopenhagë në vitin 1993 dhe për këtë njihen si Kriteret e Kopenhagës. Dallojmë tre kriteret:

- ▶ kriteret politike, që e nënkuptojnë ekzistimin e institucioneve stabile që e garantojnë demokracinë, sundimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pakicave;
- ▶ kriteret ekonomike, që e nënkuptojnë ekzistimin e ekonomisë funksionale të tregut dhe kapacitetin për ballafaqim me konkurrencën dhe forcat tregtare në BE;
- ▶ kriteret juridike, që e nënkuptojnë aftësinë për plotësimin e obligimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, përfshirë edhe unionin politik, ekonomik dhe monetar.

3 Kur do ta plotësojë kriterin politik Republika e Maqedonisë?

Në momentin kur në Republikën e Maqedonisë do të ekzistojnë institucione stabile (që nuk e ndryshojnë përbërjen e administratës me ndryshimin e pushtetit), të cilat e garantojnë demokracinë (janë transparente, të hapura, efektive, efikase dhe nuk supozojnë çka dëshirojnë qytetarët, por i konsultojnë ata për çështjet e rëndësishme shoqërore) dhe që udhëhiqen nga ligjet dhe jo bindjet e ndonjë partie politike, si dhe kur t'i mbrojnë të drejtat themelore qytetare dhe të pakicave (e drejta për informim të drejtë dhe jo imponimit të informatave selektive, e drejta për shprehjen e mendimit që nuk duhet çdoherë të përputhet me mendimin e pushtetit, e drejta për arsim cilësor, e drejta për punësim sipas kualifikimeve të kandidatit dhe jo librezës partiake, etj). Dhe, kuptohet, në momentin kur zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike do të bëhen dukuri normale që nuk do ta angazhojë tërë strukturën policore.

4 Kur do ta plotësojë kriterin ekonomik Republika e Maqedonisë?

Republika e Maqedonisë do të mund të thotë që e ka plotësuar kriterin ekonomik në momentin kur nuk do të intervenojë në treg me masa proteksioniste, kur konkurrenca jolojale nuk do ta prish tregun vetëm për shkak se ka lidhje të afërta me pushtetin, kur nuk do të ketë kontroll selektiv të kompanive, kur rregullat e njëjta do të vlejnjë për të gjitha kompanitë, kur furnizimet publike do të ndahen sipas efektit të realizuar dhe jo lidhjeve politike dhe atëherë kur gjyqet do të vendosin shpejtë dhe në mënyrë profesionale në kontestet afariste.

Kompanitë që do të ekzistojnë në Maqedoninë e këtillë do të përparojnë shpejtë, do të mund të ballafaqohen lehtë me presionin e konkurrencës dhe forcave ekonomike të BE-së dhe tërë energjinë dhe burimet do t'i orientojnë drejt inovacioneve dhe hulumtimit.

5 Kur do ta plotësojë kriterin juridik Republika e Maqedonisë?

Kriteri juridik do të përmbushet në mënyrë afatgjate. Republika e Maqedonisë duhet ta merr tërë legjislacionin e BE-së dhe ta inkorporojë në legjislacionin nacional, proces ky që realizohet intenzivisht që nga viti 2001. Çdo vit, Qeveria e miraton Planin nacional për inkorporimin e të drejtës së Bashkimit Evropian. Por, plotësimi i këtij kriteri nuk e nënkupton vetëm miratimin e ligjeve, por edhe zbatimin e tyre me përpikëri. Për këtë, nevojiten institucione të fuqishme që i përmbahen parimit të sundimit të të drejtës. Obligimet e anëtarësimit e nënkuptojnë edhe aparatit shtetëror që jo vetëm i zbaton ligjet, por ka aftësi edhe për pjesëmarrje aktive në krijimin e ardhmërisë së Bashkimit Evropian.

6 Cilat hapa i ka ndërmarrë Republika e Maqedonisë në procesin e aderimit drejt Bashkimit Evropian?

Republika e Maqedonisë zhvillon marrëdhënie dypalëshe me Bashkimin Evropian që nga momenti i mëvetësisë, gjegjësisht që nga viti 1995, kur shtetet-anëtare të BE-së e kanë pranuar Republikën e Maqedonisë dhe kanë vendosur marrëdhënie diplomatike. Në këtë periudhë, Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë hapa të ndryshëm për aderim drejt BE-së dhe tani është shtet-kandidat për anëtarësim, që e pret fillimin e negociatave.

Ja si ka rrjedhur procesi:

HAPI 1.

POLITIKA PËR ZGJERIMIN E BE-SË QË E PARASHEH MUNDËSINË PËR ANËTARËSIMIN E SHTETEVE TË INTERESUARA:

- Ky hap është kryer. Në vitin 2003, BE tha qartë që shtetet e Ballkanit perëndimor mund të bëhen shtete-anëtare të BE-së. Kjo ka ndodhur gjatë kryesisë greke me Bashkimin Evropian dhe për këtë arsye procesi quhet Agjenda e Selanikut.

HAPI 2.

BE BËN STUDIM TË REALIZUESHMËRISË PËR TË PARË NËSE SHTETI I INTERESUAR KA KAPACITETE PËR ANËTARËSIM:

- Edhe ky hap është ndërmarrë. Më 21 qershor 1999, BE e ka hartuar studimin e realizueshmërisë për RM, duke konstatuar që vendi ka kapacitet për fillimin e procesit.

HAPI 3.

HAPJA E NEGOCIATAVE PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM (MSA):

- Edhe ky hap është ndërmarrë. Më 8 mars 2000 janë hapur negociatat për nënshkrimin e MSA-së, që është nënshkruar më 24 nëntor 2000.

HAPI 4.

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM (MSA) MES REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE BE-SË:

- Edhe ky hap është ndërmarrë, më 9 prill 2001, në mes të krizës më të madhe në Republikën e Maqedonisë, që flet për vullnetin e BE-së.

HAPI 5.

RATIFIKIMI I MARRËVESHJES PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM (MSA):

- Edhe ky hap është ndërmarrë. Kuvendi i RM-së e ka ratifikuar MSA-në më 12 prill 2001, kurse ratifikimi nga shtetet tjera ka zgjatur më tepër, meqë 15 shtetet e BE-së është dashur ta nënshkruajnë atë, MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2004.

HAPI 6.

PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR ANËTARËSIM:

- Edhe ky hap është ndërmarrë më 28 mars 2004. Pastaj kemi pritur që Komisioni Evropian ta hartojë PyetëSORIN, të cilit është dashur t'i përgjigjemi. PyetëSORIN e kemi pranuar më 1.10.2004 - e besoni ose jo - personalisht nga Kryetari i atëhershëm i Komisionit Evropian, z. Romano Prodit, që flet për vullnetin politik të Bashkimit Evropian.

HAPI 7.

DORËZIMI I PËRGJIGJEVE TË PYETËSORIT:

- Edhe ky hap është ndërmarrë. Në ditën e të dashuruarve, 14 shkurt 2005, Republika e Maqedonisë e ka përgjigjur PyetëSORIN në 14.000 faqe, të dorëzuar në Bruksel. Me këtë rast, Javier Solana ka deklaruar që "kjo është letra më e gjatë e dashurisë, që e ka pranuar BE-ja".

HAPI 8.

RAPORTI PËR MENDIMIN POZITIV DHE REKOMANDIMI PËR DHËNIEN E STATUSIT TË SHTETIT-KANDIDAT PËR ANËTARËSIM NË BE:

- Edhe ky hap është ndërmarrë. Më 9 nëntor 2005, Komisioni Evropian e ka analizuar Pyetësorin dhe e ka hartuar Raportin analitik, që është bazuar në rekomandimin për dhënie e statusit shtet-kandidat për anëtarësim në BE.

HAPI 9.

MARRJA E STATUSIT TË SHTETIT-KANDIDAT PËR ANËTARËSIM NË BE:

- Edhe ky hap është ndërmarrë, më 15-16 dhjetor 2005. Republika e Maqedonisë e ka fituar statusin e shtetit-kandidat nga Këshilli i BE-së, gjatë kryesisë së Mbretërisë së Bashkuar. Për rikujtim, me statusin na është thënë se çka duhet të bëjmë për t'i filluar bisedat për anëtarësim: 1) Zgjedhet parlamentare demokratike; 2) Miratimi Ligjit për polici; 3) Reforma e Këshillit shtetëror gjyqësor dhe emërimi i anëtarëve të tij; 4) Sistemi një-sportel për regjistrimin e kompanive dhe 5) Zbatimi i drejtë i MSA-së.

7 Çka mbetet?

Mbetet vetëm edhe Hapi 10.

HAPI 10.

MARRJA E REKOMANDIMIT PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE, SË BASHKU ME PROGRES-RAPORTIN NGA KOMISIONI EVROPIAN

- Këtu kemi ngecur dhe assesi nuk mund ta bëjmë këtë hap. Për rikujtim, para zgjedhjeve të vitit 2006 është rrumbullakosur sistemi një-sportel dhe është miratuar Ligji për media. Zgjedhjet vijuese të vitit 2006 janë vlerësuar si demokratike, kurse Qeveria e re e ka miratuar menjëherë Ligjin për polici. Ka mbetur vetëm edhe Këshilli shtetëror gjyqësor,

por kjo është shndërruar në përrallë pa fund. Kjo ka zgjatur dy vite. Për të lëvizur tutje nga pika e vdekur, Komisioni Evropian na dha 8 kritere dhe u obligua që do ta jep rekomandimin pas plotësimit të tyre.

Për ta kuptuar këtë më lehtë, rrëfimi i Maqedonisë duket kështu: Maqedonia dëshiron të ndërtojë shtëpi në BE. Plani gjeneral dhe detaj urbanistik (hapi 1) na jep mundësi të këstillë, por parasheh edhe procedurë dhe kushte që duhet përmbushur (hapi 2, 3, 4, 6). Maqedonia e ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për lejen e ndërtimit (hapi 7). Organet kompetente e kanë shqyrtuar kërkesën (hapi 8) dhe na kanë lejuar ndërtimin, madje edhe na kanë siguruar të holla për ndërtim (hapi 9). Por, tani Maqedonia dëshiron ta fillojë ndërtimin prej kulmit dhe investuesi (BE) nuk lejon, duke insistuar që të fillohet prej themelit (SË PARI, REKOMANDIMI në raport), pastaj muret (DATA) dhe në fund çatia (NEGOCIATAT), gjegjësisht duhet ta ndërmarrim hapin e fundit.


8 Çka pastaj?

Me supozim që zgjedhjet presidenciale dhe lokale vlerësohen si të drejta dhe demokratike, Republika e Maqedonisë duhet t'i plotësojë të gjitha tetë kriteret për marrjen e rekomandimit për fillimin e negociatave nga Komisioni Evropian, në Progres-Raportin e vitit 2009. Rekomandimi më pas do të shqyrtohet nga Këshilli i BE-së dhe do ta përcaktojë datën për fillimin e bisedimeve. Por, negociatat nuk mund të fillojnë menjëherë. Pse? Është e parralizueshme që Maqedonia të bisedojë me 27 shtetet-anëtare në të njëjtën kohë dhe për këtë arsye, Komisioni Evropian është ai që negocion. Për këtë, duhet ta merr mandatin prej të gjitha shteteve-anëtare. Komisioni Evropian do ta bëjë të a.q. screening ose skenimin e legjislativës tonë dhe më pas, në bazë të rezultateve

shtetet-anëtare vetë do t'i caktojnë pozitat për të gjitha 35 kapitujt. Këto qëndrime do të udhëhiqen nga Komisioni Evropian në negociata dhe KE do të dijë sa mund të lëshojë pe në çështjet e caktuara. Negociatat do të zgjasin disa vite. Pas përfundimit të negociatave, pason nënshkrimi i marrëveshjes për anëtarësim dhe ratifikimi në të gjitha parlamentet

e shteteve-anëtare, përfshirë edhe Kuvendin tonë dhe Parlamentin Evropian.

Me supozim që Republika e Maqedonisë do ta fitojë rekomandimin për fillimin e negociatave me Komisionin Evropian në nëntor 2009, rruga e jonë drejt anëtarësimit do të duket kështu:



CILAT JANË TË DREJTAT THEMELORE QYTETARE DHE NJERËZORE NË BASHKIMIN EVROPIAN?

9 A ekziston nënshtetësia evropiane?

Po. Nënshtetësia është marrëdhënie publike-juridike mes shteteve dhe nënshtetasve, që krijon obligime për të dy palët. Në BE ka përpjekje për promovimin e nënshtetësisë evropiane, si koncept që i bashkon qytetarët e shteteve-anëtare nën ombrellën e vlerave dhe parimeve të përbashkëta për të gjitha shtetet-anëtare, si dhe të Bashkimit Evropian.

10 Çka nënkupton nënshtetësia evropiane?

Koncepti i nënshtetësisë evropiane e nënkupton:

- a. lëvizjen e lirë në kuadër të Bashkimit Evropian:
 - të drejtën e zgjedhjes së vendbanimit/vendqëndrimit në cilindo shtet-anëtar dhe
 - ë drejtën e udhëtimit në shtetet-anëtare pa viza dhe pa nevojë të kontrollit të pasaportave, që lidhet me lirinë e lëvizjes së personave;
- b. të drejtën e mbrojtjes diplomatike të nënshtetasve evropianë;
- c. të drejtën e pjesëmarrjes në vendim-marrje për çështjet e lidhura me bashkësinë lokale ku jeton personi ose të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale si votues, por edhe si kandidat për ushtrimin e funksionit.

11 A e zëvendëson nënshtetësia evropiane nënshtetësinë e shteteve-anëtare?

Jo. Nënshtetësia evropiane nuk e zëvendëson dhe nuk mund ta zëvendësojë shtetësinë e shteteve-anëtare. Sovraniteti i shteteve-anëtare është i pakontestueshëm dhe marrëdhënia e tyre me qytetarët është e paprekshme. Nënshtetësia evropiane vetëm e plotëson shtetësinë e shtetit-anëtar dhe gjatë kësaj i jep cilësi plotësuese dhe të re, të lidhur me vlerat dhe parimet. Së këndejmi, pas anëtarësimit në BE, shtetasit e Republikës së Maqedonisë do të kenë edhe nënshtetësi evropiane dhe do të mund t'i gëzojnë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga ajo.

12 Kush i mbrojnë nënshtetasit evropianë?

Mbrojtja e të drejtave të shtetësisë evropiane kryhet në radhë të parë nga institucionet e shtetit-anëtar, meqë realizimi i të drejtave realizohet në radhë të parë në vendin ku jeton personi. Më tej, mbrojtja e të drejtave të nënshtetësisë evropiane kryhet edhe nga institucionet evropiane, nënkuptohet, në pjesën nën ingerencat e tyre. Në fund, mbrojtja e shtetasve evropianë që gjenden jashtë vendit kryhet nga përfaqësitë diplomatike-konsulare. Secili qytetar e ka të drejtën e mbrojtjes

diplomatiqe nga përfaqësia diplomatike e shtetit-anëtar prej ku vjen. Në shtetet ku ndonjë prej shteteve-anëtare nuk është përfaqësuar, mbrojtja diplomatike e shtetasve të saj mund të jepet nga përfaqësia diplomatike-konsulare e cilitdo shtet tjetër anëtar.

13 Çfarë pune bën Ombudsmani evropian?

Ombudsmani evropian është nëpunës/funksionar i Bashkimit Evropian, që kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve evropianë, nga shkeljet që mund të bëhen nga institucionet evropiane. Ombudsmani evropian ka rol të rëndësishëm në kontrollin e funksionimit të institucioneve evropiane dhe respektimit të Kodit të sjelljes së mirë. Ai ushtron edhe kontroll të qeverisjes së mirë, sipas ankesave të parashtruara nga qytetarët evropianë, përmes parashtrimit të raporteve në Parlamentin Evropian.

14 Cili është dallimi mes të drejtave të njeriut dhe të drejtave nga e drejta e BE-së?

Kur flitet për të drejtat e njeriut në Bashkimin Evropian, zakonisht mendohet në Konventën evropiane për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, ose më mirë, Kartës së Bashkimit Evropian për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Dokumenti i parë është i njohur mirë për ne, meqë është ratifikuar edhe nga Republika e Maqedonisë dhe ai i mbron të drejtat themelore njerëzore të qytetarëve tonë, para gjykatave tona, si dhe para Gjyqit evropian për të drejtat e njeriut. Dokumenti i dytë është dokument i Bashkimit Evropian dhe

rrjedh nga Marrëveshja e re reformuese, e njohur më shumë si Traktati i Lisbonës. Të drejtat nga e drejta e BE-së janë më të gjëra se të drejtat e njeriut, gjegjësisht janë të drejta që rrjedhin nga tërë legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe gëzohen nga të gjithë shtetasit evropianë. Të drejtat e të drejtës së BE-së kanë të bëjnë me të gjitha politikat e përbashkëta dhe për mbrojtjen e tyre kujdeset Gjyqi evropian i drejtësisë, si dhe gjyqet e shteteve-anëtare.

15 Cila është lista e të drejtave themelore qytetare dhe njerëzore, mbrojtja e të cilave rregullohet me Kartën e Bashkimit Evropian për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut?

Karta e Bashkimit Evropian për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut është përpjekja e parë e BE-së për rregullimin e të drejtave dhe lirive të njeriut me një dokument. Në kuadër të Kartës, rregullohet korpusi i të drejtave qytetare, politike, ekonomike dhe sociale të shtetasve evropianë. Të drejtat e rregulluara me Kartën grupohen në gjashtë grupe, të lidhura me dinjitetin e njeriut, liritë themelore, barazinë, solidaritetin, të drejtat qytetare, drejtësinë dhe qasjen ndaj drejtësisë. Ato bazohen në të drejtat dhe liritë e pranuar nga Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, traditat kushtetuese të shteteve-anëtare të BE-së, Karta sociale e Këshillit të Evropës, Karta e Bashkësive për të drejtat themelore sociale të punëtorëve, si dhe shumë marrëveshje tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shtetet-anëtare të BE-së.

TË HOLLAT EVROPIANE

16 Si planifikohen të hollat evropiane?

Për shpenzimin më strategjik të mjeteve, Bashkimi Evropian i planifikon mjetet në cikël shtatë-vjeçar, që quhet perspektiva financiare, e cila i përfshin vitet 2007-2013 dhe i pasqyron prioritetet e BE-së (duke i arsyetuar të hollat e shpenzuara nga buxheti i BE-së), gjegjësisht:

- ▶ për BE më konkurrencte, për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës (Politika rajonale e BE-së);
- ▶ për bujqësi, peshkatarë dhe mjedis jetësor;
- ▶ për politikën e jashtme dhe përforcimin e rolit të BE-së në skenën botërore (qëllimi që BE të shndërrohet në lojtar botëror);
- ▶ për nënshtetësi evropiane (Punët e brendshme dhe drejtësia);
- ▶ për shpenzimet administrative të institucioneve të BE-së.

Prioriteti i tretë është i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë. Është e qartë që BE planifikon të imponohet në skenën botërore dhe t'i shpalojë "vlerat" e saj, mes të cilave numërohet edhe siguria, gjegjësisht "eksporti i sigurisë". Nëse e shohim ndihmën e reformuar të jashtme (prej kur rrjedh edhe IPA) do të vërejmë që BE inkorporon instrumente të reja. Për promovimin e vlerave të saj, BE ka krijuar edhe një mekanizëm gjegjës (për herë të parë), gjegjësisht instrumentin për bashkëpunim me shtetet dhe territoret e industrializuara dhe

shtetet me të hyra të larta (që do të thotë se përzihen mjetet me SHBA, Kanadanë, Australinë, etj). Edhe instrumenti për stabilitet është i ri, për shkak të "eksportit të stabilitetit" dhe i ngjan shumë Marrëveshjes kornizë në Maqedoni. Së këndejmi, Maqedonia duhet ta kapitalizojë Marrëveshjen kornizë (ose të paktën ta shfrytëzojë si përparësi konkurrencte ndaj shteteve tjera).

17 Si vendos Bashkimi Evropian për shpenzimin e të hollave?

Pas përcaktimit të prioriteteve globale për kornizën financiare shtatëvjeçare, BE i përcakton çështjet ku duhet fokusuar dhe që duhet të mbështeten financiarisht. Korniza financiare 2007-2013 quhet edhe Agjenda e re e Lisbonës dhe i përcakton tre qëllimet që duhet të përmbushen nga BE. Qëllimi i parë është përmirësimi i atraktivitetit të shteteve-anëtare, rajoneve dhe qyteteve, përmes përmirësimit të qasjes, sigurimit të cilësisë adekuate të shërbimeve dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Kjo do të thotë që BE do të financojë zgjerim dhe përmirësim të rrjetit transportues, do ta rrisë sinergjinë mes mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe rritjes, si dhe do ta zgjidhë problemin evropian me shfrytëzimin intensiv të burimeve tradicionale të energjisë. Qëllimi i dytë i BE-së është inkurajimi i inovacioneve, sipërmarrësisë dhe ekonomisë së diturisë, përmes hulumtimeve dhe inovacioneve, përfshirë edhe teknologjitë e reja informatike-

teknologjike. Kjo do të thotë që BE do të investojë në rritjen e hulmtimeve dhe zhvillimin e teknologjisë, do ta inkurajojë sipërmarrësinë dhe inovacionet, do ta promovojë shoqërinë informatike për të gjithë dhe do ta përmirësojë qasjen ndaj financave. Qëllimi i tretë i BE-së është hapja e më shumë vendeve më të mira të punës, përmes punësimit dhe aktiviteteve të sipërmarrësisë, përmirësimit të përshtatshmërisë së punëtorëve dhe ndërmarrjeve, si dhe investimit të shtuar në burimet njerëzore. Kjo do të thotë që BE do të financojë projekte me të cilat atraktohen dhe mbahen njerëzit në marrëdhënie pune, kurse shtetet-anëtare do t'i modernizojnë sistemet e tyre të mbrojtjes sociale, do ta përmirësojnë përshtatshmërinë e punëtorëve, ndërmarrjet do ta rrisin fleksibilitetin e tregut të punës dhe do të investojnë në kapitalin njerëzor (përmes arsimit më të mirë dhe aftësive më të mëdha), si dhe do ta rrisin kapacitetin administrativ të shteteve-anëtare dhe do të sigurohet ndihmë për mbajtjen e forcës së shëndoshë punuese.

18 Si vendos BE-ja ku do të shpenzohen të hollat e instrumentit për ndihmë para-anëtarësimi (IPA)?

Është logjike që korniza strategjike e BE-së për periudhën 2007-2013 të inkorporohet në të gjitha instrumentet tjera financiare, përfshirë edhe instrumentin për ndihmë para-anëtarësimi (IPA). Për këtë arsye, kur vështrohen nga afër projektet që do të mbështeten nga IPA, vërehet reflektimi i tre qëllimeve të BE-së (rrjetat transportuese, energjia, mjedisi jetësor, sipërmarrësia, inovacionet, hulmtimi, burimet njerëzore, zhvillimet bujqësore, etj). Megjithatë, qëllimi kryesor i IPA është sipërmarrësia dhe për këtë arsye, një pjesë e mjeteve do të dedikohen për përgatitjen e shtetit për anëtarësim, përmes ndërtimit të institucioneve

adekuate që do të jenë në gjendje t'i marrin përsipër të gjitha obligimet nga anëtarësimi në BE.

19 Si është strukturuar IPA dhe pse?

Struktura e IPA varet prej dy gjërave: a) për kë dedikohet dhe b) çka përkrahet. Më herët, para vitit 2007, kanë ekzistuar dy instrumente të ndryshme për shtetet-kandidate (PHARE, ISPA dhe SAPARD) dhe për shtetet-kandidate potenciale (CARDS). Të gjitha këto instrumente kanë pasur rregulla të posaçme për administratën. Për ta lehtësuar kalimin e shteteve nga një status në tjetrin, duke mos shkaktuar ndërprerje në shfrytëzimin e mjeteve, BE ka paraparë që IPA t'i trajtojë shtetet me dy statuset e ndryshme. Së këndejmi, IPA strukturohet në pesë komponenta (I komponenta për ndërtimin e institucioneve dhe tranzicion, II komponenta për bashkëpunim tejkuftar, III komponenta për zhvillim rajonal, IV komponenta për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe V komponenta për zhvillim rural). Por, pjesëmarrja e shteteve-kandidate potenciale kufizohet vetëm në dy komponentët e para. Pse?

Për ta përgjigjur këtë pyetje, duhet të shohim për çka shërben secila komponentë. Komponenta e parë shërben për ndërtimin e institucioneve dhe tranzicion (gjegjësisht për tranzicionin e shteteve-kandidate në shtete-anëtare të BE-së), kështu që është logjike që kjo komponentë t'i ndërtojë kapacitetet e institucioneve që duhet t'i kenë shtetet, nëse dëshirojnë të bëhen anëtarë të Bashkimit Evropian.

Komponenta e dytë shërben për bashkëpunimin tejkuftar, meqë BE e inkurajon dhe beson në bashkëpunimin e ndërsjellë mes të gjitha shteteve-anëtare, posaçërisht fqinjëve. Logjika është që në këtë mënyrë më lehtë mësohet bashkëpunimi me fqinjët e parë, meqë keni probleme të përbashkëta,

kurse përvoja ju ndihmon më vonë të bashkëpunoni edhe me shtetet tjera evropiane.

Komponenta e tretë shërben për zhvillim rajonal, që kryesisht përkrahet prej dy burimeve: a) kreditë e Bankës investuese evropiane (BIE) dhe b) Fondit evropian koheziv (ECF) që dedikohet vetëm për shtetet-anëtare. Me këtë komponentë, shtetet-kandidate do të ndërtojnë kapacitete për shfrytëzimin e mjeteve të Fondit koheziv, që të mos ketë ndërprerje pas anëtarësimit në BE.

Komponenta e katërt shërben për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe financohet përmes Fondit social evropian (FSE), që dedikohet vetëm për shtetet-anëtare. Me këtë komponentë, shtetet-kandidate i ndërtojnë kapacitetet për shfrytëzimin e mjeteve nga ky fond, në momentin kur të bëhen anëtarë të BE-së.

Në fund, komponenta e pestë shërben për zhvillim rajonal, që përkrahet përmes Fondit evropian bujqësor për zhvillim rural (EAFRD). Me këtë komponentë, shtetet-kandidate do të bëjnë dy punë: a) do t'i ndërtojnë kapacitetet për shfrytëzimin e mjeteve të këtij fondi kur të anëtarësohen në BE dhe b) do të duhet të japin kontribut në reformimin e Politikës së përbashkët bujqësore në BE.

Kjo strukturë e IPA i nevojitet BE-së për t'i trajtuar shtetet me status të shteteve-kandidate, por edhe shteteve potenciale candidate. Në fakt, shtetet me status të shteteve-kandidate potenciale (Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia, përfshirë edhe Kosovën) kanë qasje vetëm në dy komponentat e para, kurse shtetet-kandidate (Maqedonia, Kroacia dhe Turqia) kanë qasje në të gjitha pesë komponentët, meqë është e qartë që një ditë edhe ato do të jenë shtete-anëtare.

20 Kush mund të jetë shfrytëzues i mjeteve të IPA?

Për të kuptuar më lehtë kush mund t'i shfrytëzojë mjetet nga IPA, duhet të shohim cilat janë dedikimet e mjeteve. Me ndihmën nga IPA do të:

- a. përforcohen institucionet demokratike, sundimi i të drejtës dhe zbatimi i ligjeve, që do të thotë se mjetet e dedikuara për institucionet shtetërore, gjyqësorin, trupat e pavarur rregullatore dhe agjencitë, vetëqeverisja lokale, Kuvendi, organizatat e shoqërisë civile dhe tjerë;
- b. promovohen dhe mbrohen të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe do të përforcohet respektimi për të drejtat e pakicave, përfshirë edhe promovimin e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit, që do të thotë se do të mbështetet edhe Avokati i popullit, Kuvendi, organizatat joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut, çështjet e femrave dhe monitorim dhe që i përfaqësojë interesat e grupeve pakicë dhe të marginalizuara;
- c. reformohet administrata publike, përfshirë edhe krijimin e sistemit të menaxhimit të decentralizuar me ndihmë, gjegjësisht do të përkrahen strukturat shtetërore që menaxhojnë me të hollat evropiane, por edhe Enti shtetëror për revizion, vetëqeverisjet lokale dhe organizatat qytetare që ushtrojnë mbikëqyrje të mënyrës së shpenzimit të mjeteve buxhetore në Republikën e Maqedonisë;
- d. reformohet ekonomia, që do të thotë se përkrahen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Drejtoria e të hyrave publike, Drejtoria doganore, Banka popullore, odat ekonomike, organizatat profesionale dhe ekologjike, etj.
- e. zhvillohet shoqëria qytetare, që do të thotë se do të mbështeten organizatat qytetare, mediat,

universitetet, organizatat eksperte dhe grupet fetare;

- f. punojë për përfshirjen sociale, që do të thotë se mbështeten sindikatat, organizatat joqeveritare që i trajtojnë grupet e marginalizuara, veçanërisht romët, institucionet arsimore dhe tjerat;
- g. realizohen masa për pajtim, ndërtim të besimit dhe rikonstruim, që do të thotë se do të mbështeten organizatat që merren me marrëdhëniet ndër-etnike, institucionet arsimore, organizatat rinore, organizatat rome, vetëqeverisjet lokale dhe tjerat;
- h. përkrahet bashkëpunimi rajonal dhe tejkufitar, që do të thotë se do të përkrahen projektet e vetëqeverisjeve lokale, organizatave të shoqërisë civile, ndërmarrjeve publike, bashkësive lokale, institucioneve arsimore, enteve të shëndetit publik dhe tjerat, nga dy anët e kufirit.

21 Si programohen mjetet e IPA?

Programimi i IPA është proces strategjik që kërkon përfshirje komplete të shteteve dhe Komisionit Evropian. IPA ndahet në pjesën rajonale (që quhet IPA me shumë përfitues) dhe pjesën nacionale (që i prek shtetet e caktuara shfrytëzuese). Më pas, Komisioni Evropian ia ndan të hollat shteteve sipas numrit të banorëve dhe komponentëve, për çdo vit. Kjo kornizë financiare quhet Korniza financiare indikative disavjeçare.

Pas definimit të mjeteve për kornizën financiare, Komisioni Evropian e harton të a.q. Dokument për planifikim indikativ disavjeçar, në këtë rast për Republikën e Maqedonisë, me periudhë trevjeçare.

Në këtë dokument ceken problemet e shtetit që duhet trajtuar, por nuk shkohet në planifikimin detaj të projekteve. Dokumenti azhurnohet çdo vit, kështu që tani ka Dokument për planifikim indikativ disavjeçar për Republikën e Maqedonisë 2007-2009 dhe 2008-2010, kurse 2009-2011 është në hartim e sipër.

Dokumenti për planifikim indikativ disavjeçar për Republikën e Maqedonisë është baza për programimin e mëtejshëm të projekteve detaje që do të financohen nga IPA. Por, para hartimit të propozim-projekteve (që quhen projekt-fishe), hartohen të a.q. programe operative. Në komponentën e dytë, tretë, katërt dhe të pestë, programet operative e mbulojnë periudhën 2007-2013, kurse për komponentën e parë hartohet programi operativ për çdo vit (për momentin, janë hartuar programet operative për 2007 dhe 2008). Në fund hartohen propozim-projektet dhe ato tenderohen.

Për programimin e mjeteve nga IPA duhet cekur që programohen së bashku nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përmes Sekretariatit për çështje evropiane. Në pajtim me rregullativën për zbatimin e IPA, parashihet edhe procesi këshillëdhënës me palët e prekura, para miratimit të dokumenteve finale. Për momentin, ky proces këshillëdhënës realizohet vetëm nga Komisioni Evropian.

TREGU I PËRBASHKËT EVROPIAN DHE PESË LIRITË

22 A është nënkuptimi i njëjtë i nocionit “tregu i përbashkët” dhe “tregu i brendshëm”?

Jo. Megjithatë, dallimi mes dy nocioneve është i vogël. Tregu i përbashkët është formë më e avancuar e tregut të brendshëm - tregu i përbashkët nënkupton më tepër përpjekje për mënjanimin e barrierave fizike (kufijve), barrierave teknike (standardeve) dhe atyre fiskale (tatimeve) mes shteteve-anëtare. Për mënjanimin e barrierave të cekura, nevojitet vullneti i fuqishëm politik i shteteve, për krijimin e politikave të përbashkëta ekonomike.

23 Sipas kësaj, Bashkimi Evropian si tërësi nuk është treg i përbashkët?

Saktë. Për shkak të mosekzistimit të tatimimit të unifikuar, fakti që të gjitha shtetet në BE nuk e përdorin euron si mjet pagesor dhe që a shtete nuk e kanë nënshkruar konventën e Shengenit - BE si tërësi nuk është treg i përbashkët.

24 Pse konsiderohet tregu i përbashkët si e arritur më e madhe e Bashkimit Evropian?

Për shkak se në kuadër të tregut të përbashkët nuk ekzistojnë kufi dhe mundësohet lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit, njerëzve, forcës së punës dhe diturisë.

25 Cilat janë përfitimet e tregut të përbashkët për banorët e BE-së?

Ka shumë përfitime - lëvizja e lirë e turistëve, pensionimi i lirshëm dhe gëzimi i të drejtave në vendet tjera, studimi dhe puna pa kufizime, lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve, çmimet e ulura, zgjedhja më e madhe dhe cilësia më e mirë e mallrave dhe shërbimeve, lëvizja e lirë e kapitalit dhe shërbimeve financiare, blerja e aksioneve në shtetet tjera, lëvizja e lirë e profesorëve dhe kuadrit shkencor, etj.

26 Pse banorët e BE-së duhet ta tregojnë pasaportën gjatë hyrjes prej Kroacisë në Slloveni dhe jo kur shkojnë prej Italisë në Slloveni?

Banorët e BE-së i tregojnë dokumentet e tyre të udhëtimit vetëm në kufijtë e jashtëm të BE-së - kufiri mes Kroacisë dhe Sllovenisë është kufi i jashtëm i BE-së. Nga ana tjetër, kufiri mes Italisë dhe Sllovenisë është kufi i brendshëm i BE-së dhe nuk nevojitet prezantimi i dokumenteve.

27 A e nënkupton lëvizja e lirë e mallrave në tregun e përbashkët edhe lëvizjen e lirë për absolutisht të gjitha prodhimet?

Kuptohet që jo. Lëvizja e lirë e mallrave lejohet për mallrat e blera për konsum personal, jo rishitje. Gjithashtu, ndalohet edhe lëvizja e lirë e substancave të palejuara.

28 A i duhet spanjollit vizë për të udhëtuar në Austri?

Jo. Liria e lëvizjes së njerëzve në kuadër të BE-së është një prej lirive themelore të lëvizjes. Kjo do të thotë që të gjithë qytetarët e shteteve-anëtare të BE-së mund të lëvizin lirshëm në BE - pa viza dhe pa iu nënshtruar kontrollit të pasaportave. Në fakt, çdo qytetar i shteteve-anëtare të BE-së udhëton në vendet tjera anëtare pa kufizime.

29 A mund gjermani të punojë ose studiojë në Rumuni?

Po, sërish në bazë të parimit të lëvizjes së lirë të njerëzve - qytetarët e shteteve-anëtare të BE-së mund të udhëtojnë studiojnë dhe punojnë lirshëm, ose të pensionohen në ndonjë prej shteteve-anëtare të BE-së.

30 Nëse blej një pako venë ose cigare në Slloveni, a duhet të paguaj doganë për futjen e tyre në Finlandë.

Jo, meqë këtu zbatohet parimi i lëvizjes së lirë të mallrave. Si rezultat i mënjanim të barrierave doganore mes shteteve-anëtare të BE-së, mallrat lëvizin pa ngarkesa tjera me taksa. Kjo do të thotë që nëse një slloven blen verë në Finlandë, mund ta bart atë në cilindo shtet tjetër anëtar të BE-së pa dogana ose akciza plotësuese.

31 A ka mundësi që kompania prej një shteti-anëtar të BE-së t'i shesë shërbimet në ndonjë shtet tjetër anëtar të BE-së?

Po, për shkak se lëvizja e lirë e shërbimeve ia garanton kompanive lirinë e themelimit të kompanive të tyre në shtetet tjera anëtare të BE-së, si dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve në shtetet tjera anëtare, anash shtetit-anëtar prej ku vijnë.

MBROJTJA E KONSUMATORËVE

35 Pse është e rëndësishme mbrojtja e konsumatorit në Bashkimin Evropian?

Në ditën e sotme, çdo qytetar është konsumator dhe për këtë arsye, BE ka kujdes të madh për mbrojtjen e shëndetit të tyre, sigurisë dhe të drejtave. BE promovon programe që fokusohen në zhvillimin e të drejtave dhe qasjen ndaj informatave për prodhimet dhe edukimin e konsumatorëve, merr hapa konkretë për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe e nxit formimin e shoqatave që kujdesen për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve është një prej qëllimeve strategjike të BE-së për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj. Meqë tregu dhe valuta e përbashkët i kanë mënjeluar kufijtë në tregti, për BE-në është çdoherë e më e rëndësishme që të gjithë 481 milionë banorët në 27 shtetet-anëtare të kenë dobi të njëjtë nga mbrojtja e lartë e konsumatorëve, veçanërisht në rritjen e shfrytëzimit të internetit dhe tregtisë elektronike.

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve, prosperiteti i tyre dhe mirëqenia janë vlerat themelore të BE-së. Së këndejmi, legjislacioni i BE-së dizajnohet në mënyrë që ta mundësojë hapjen dhe transparencën e tregut të përbashkët, me çka konsumatorët do të kenë zgjedhje të mirëfilltë gjatë blerjes dhe do të trajtohen fer në cilindo shtet-anëtar. Në vijim do të përpiqemi t'i prezantojmë të drejtat më të rëndësishme të konsumatorëve, në kuadër të Bashkimit Evropian.

36 A mund të blejnë shtetasit evropianë kudo që dëshirojnë, gjithçka që dëshirojnë dhe sado që dëshirojnë?

Qytetarët e BE-së mund të blejnë kudo në BE dhe t'i sjellin prodhimet në shtëpi, pa paguar tatime, TVSH ose taksa tjera. Kjo vlen për prodhimet e blera në shtetet tjera anëtare, si dhe prodhimet e porositura nga këto vende përmes internetit, postës ose telefonit.

37 Çka nëse prodhimi i blerë nuk funksionon?

“Malli i blerë nuk kthehet” nuk është shprehje me të cilën janë mësuar qytetarët e BE-së. Përkundrazi, nëse prodhimi i blerë nuk duket ose nuk funksionon sipas përshkrimit në reklamë ose nuk i plotëson nevojat për të cilat dedikohet, konsumatorët kanë të drejtë ta ndërrojnë, pa asnjë kompensim. Nëse nuk mundësohet ndërrimi i prodhimit në periudhën e kuptueshme kohore, konsumatorët kanë të drejtë t'i kërkojnë të hollat mbrapa. Periudha minimale e garancisë është 2 vite dhe vlen për të gjitha prodhimet e shitura në shtetet e BE-së.

38 A mund të ndjehem i sigurt gjatë shfrytëzimit të prodhimeve të blera?

Standardet mjaft të larta të sigurisë (mes më të lartave në botë) aplikohen për të gjitha prodhimet, si që janë lojërat, aparatet shtëpiake, veturat, kozmetika, etj që shiten në BE. Prodhuesit dhe distributorët obligohen të ofrojnë dhe shesin prodhime që i plotësojnë këto standarde të sigurisë. Në nivel të BE-së funksionon edhe mekanizmi special për informim, që mundëson përhapjen e shpejtë të informatave për prodhimet që mund të zbulohen si të pasigurta për shfrytëzim. Ky mekanizëm kujdeset edhe për mënjanimin e prodhimeve të këtilla nga tregu.

39 Si ta di çka konsumoj, nëse nuk mund ta shoh prodhimin përmes ambalazhit?

Legjislacioni i BE-së që vlen për etiketat dhe paketimin e ushqimit i mundëson konsumatorëve të informohen për prodhimin që e konsumojnë. Etiketat e ushqimit patjetër japin informata të detajuara për përmbajtjen, përfshirë edhe ato që shkaktojnë alergji (për shembull, kikirikët, qumështi ose vezët). Nëse ndonjë prodhim shfrytëzon organizma të modifikuar gjenetiksht, kjo duhet medoemos të ceket në paketim. Gjithashtu, përdorimi i fjalës "organike" rregullohet në mënyrë të rreptë, si dhe përdorimi i emrave që asociojnë në ndonjë cilësi të ndonjë rajoni në Evropë (për shembull, qumështi i Alpeve ose prosciutto di Parma).

40 A ekzistojnë kushte që duhet t'i plotësojnë kontratat për shitje?

Legjislacioni i BE-së i trajton si të pavlefshme kontratat që janë të padrejta ndaj konsumatorëve, pa dallim në cilin vend të BE-së janë nënshkruar. Për shembull, dispozitat që parashohin se depozita nuk kthehet, madje edhe nëse shitësi nuk e dorëzon prodhimin, trajtohen si të padrejta dhe nuk janë obligative. Gjegjësisht, edhe nëse nënshkruhet kontrata e këtillë, do të konsiderohet si e pavlefshme dhe shitësi do të obligohet ta kthejë depozitën e pranuar.

41 A mund të anulohet kontrata e lidhur?

Në situata të caktuara, BE lejon kohë në të cilën konsumatorët mund ta ndërrojnë mendjen për ndonjë kontratë të caktuar. Kështu nëse blini polisë sigurimi përmes telefonit ose internetit, ju mund ta ndërroni mendjen brenda 30 ditëve dhe ta anuloni kontratën pa asnjë pasojë. Kjo vlen për të gjitha prodhimet e vlera përmes telefonit ose internetit në BE.

42 Si të vendos cila ofertë është më e mira?

Konsumatorët në BE patjetër duhet të kenë mundësi për krahasim të lehtë të prodhimeve, për të vendosur cila ofertë është më e leverdishme. Për këtë, shitësit obligohen ta prezantojnë çmimin total të prodhimeve, përfshirë edhe TVSH-në, si dhe çmimin e prodhimit "për njësi" gjegjësisht çmimin

e shprehur për 1 kilogram ose 1 litër. Në mënyrë të ngjashme, institucionet financiare duhet t'i japin informatat për shërbimet e tyre në formën e standardizuar, me qëllim të krahasimit të lehtë.

43 A mund ta shes rakinë e pjeprit si ilaç kundër humbjes së flokëve?

Me qëllim që të lejohet marrja e vendimeve të informuara nga konsumatorët, BE e ndalon reklamimin që shkakton lajthitje ose i bind konsumatorët. Për shembull, reklamat dhe materialet propagande nuk mund të pohojnë se prodhimi i caktuar shëron ndonjë sëmundje, nëse nuk ka studime të dëshmuara shkencore që e konfirmojnë pohimin. Më tej, kur flitet për shitje përmes telefonit, postës, internetit - shitësit duhet të jenë të hapur, transparentë dhe fer ndaj konsumatorëve.

44 Çka nëse në etiketën shkruan që prodhimi është raki komova me 50% alkool, kurse prodhimi është raki e kajsive me 45% alkool?

Të gjithë prodhuesit në BE obligohen t'i shënojnë përbërësit në prodhimet e tyre. Të gjitha deklaratat dhe pohimet për prodhimet e caktuar duhet të jenë të vërteta dhe shitësi bart përgjegjësi në të kundërtën. Kjo vlen edhe për përshkrimet ose ofertat që jepen në reklama, materiale promovionale ose deklaratat me shkrim dhe gojore të shitësit. Së këndejmi, në BE nuk mund të ketë materiale promovionale që

"arsyetohen" me gabime të shkrimit. Këto rregulla vlejné edhe për fushatat promovionale.

45 Sa duhet të zgjasë periudha e garancisë për prodhimet e blera?

Për t'i mbrojtur konsumatorët në nivel të BE-së, janë unifikuar afatet minimale të garancisë së prodhimeve. Si rezultat i kësaj, të gjithë konsumatorët, pa dallim në cilin shtet-anëtar i kanë vlerë prodhimet, kanë të drejtë për të paktën garanci dy-mujore për prodhimin e blerë. Nëse prodhimi pëson defekt ose ka ndonjë lëshim brenda 6 muajve të parë, ai duhet të ndërrohet në llogari të shitësit, meqë supozohet se çdo defekt në këtë periudhë është shenjë e gabimit të prodhuesit. Nga ana tjetër, në periudhë prej dy viteve, defekti ose lëshimi do të ndërrohet vetëm nëse konsumatori dëshmon që prodhimi është shfrytëzuar në mënyrë adekuate, gjegjësisht që defekti nuk ka ndodhur me fajin e konsumatorit.

46 Si i mbron BE-ja konsumatorët nga praktikat e padrejta afariste?

Në parim, e drejta e BE-së i mbron konsumatorët nga cilado praktikë jofer. Praktikrat më të shpeshta ndalohen edhe në mënyrë të hapur dhe janë futur në listën e zezë të BE-së, si që është presioni i shitësit të blini ndonjë prodhim të caktuar, shitja agresive dhe pa paralajmërim në derë, reklamat dhe letrat që premtojnë shpërblime të rrejtshme, krijimi i përshtypjes për oferta falas, shfrytëzimi i rrejtshëm i ofertave të kufizuara, reklamimi i qëllimshëm për ofertën e caktuar që zgjat

periudhë të caktuar kohore, shfrytëzimi i markave dhe vulave të cilësisë pa aprovim dhe certifikim, pohimi që diçka jepet si ofertë për konsumuesin duke qenë e drejtë që i takon sipas ligjit, etj.

47 A përgjigjet çdoherë prodhuesi për prodhimin e keq?

Në BE, nëse prodhimi i caktuar është blerë nga shitësi dhe jo nga vetë prodhuesi, shitësi është përgjegjës për të gjitha të drejtat që ju takojnë. Kështu, për kushtet e këqija të servisit ose për ndërrim të prodhimit, shitësit në BE nuk mund "të arsyetohen" me prodhuesin, por obligohen që riparimet ose ndërrimet t'i kryejnë vetë, sa më shpejtë, gjegjësisht brenda 30 ditëve.

48 Sa gjatë duhet t'i ruaj llogaritë fiskale për t'i realizuar të drejtat e mia?

Në BE, konsumatorët nuk duhet ta tregojnë llogarinë për t'i realizuar të drejtat e tyre. Në parim, në shumë shtete-anëtare, shitësit nuk obligohen të japin llogari, kështu që është e padrejtë që obligimi i këtillë t'i imponohet konsumatorëve. Por, nuk është e pakuptimtë që shitoret të kërkojnë dëshmi që prodhimi është blerë aty, për shembull, ndonjë çek të realizuar, ekstrakt bankar ose llogari të kredit-kartelës etj.

49 Si i ndihmon BE-ja konsumatorët për mbrojtjen e të drejtave të tyre?

Meqë të drejtat e konsumatorëve janë prioritet për Bashkimin Evropian, në të gjitha shtetet-anëtare ekzistojnë organizatat që ndërmjetësojnë gjatë kontesteve eventuale mes konsumatorëve dhe shitësve në shtetet e ndryshme anëtare. Ekziston edhe i a.q. Rrjet evropian i qendrave të konsumatorëve, që i ndihmojnë konsumatorëve në realizimin e të drejtave të tyre. Këto qendra janë aq të suksesshme, saqë qytetarët e BE-së i zgjidhin problemet e tyre për më pak se një muaj. Për shembull, një qytetar i Londrës, gjatë pushimeve në Amsterdam ka blerë xhins me zbritje. Por, pas kthimit në shtëpi e ka vërejtur që patenta nuk funksionon, e ka kontaktuar shitoren, por ajo ka refuzuar të bashkëpunojë. Blerësi është lajmëruar në Qendrën e konsumatorëve në Londër, meqë ka besuar se i takon kompensimi i plotë. Qendra i është drejtuar shitores, duke i treguar që të drejtat e konsumatorëve mbrohen me të drejtën e BE-së dhe konsumatorët kanë të drejtë për ndërrim ose riparim të prodhimit. Në fund, shitorja i ka dërguar xhins të ri blerësit nga Londra.

POLITIKA E PËRBASHKËT BUJQËSORE

50 Sa është i harmonizuar legjislacioni i Maqedonisë në fushën e bujqësisë me rregullativat e Bashkimit Evropian?

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për stabilizim-asociim, Republika e Maqedonisë e ka marrë obligimin për realizimin e procesit të harmonizimit të legjislativës nacionale me atë evropiane. Në kuadër të procesit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë harton çdo vit Program nacional për marrjen e legjislativës evropiane, ku përcaktohen prioritetet afatshkurta dhe afatgjate. Në Program ceken rregullativat juridike evropiane nga fusha e legjislacionit nacional, ku duhet realizuar inkorporimi, si dhe mjetet e nevojshme për realizimin e procesit dhe mjetet për zbatimin e legjislacionit së inkorporuar evropian.

51 Si rrjedh procesi i harmonizimit të legjislacionit dhe cili institucion është kompetent për udhëheqjen e procesit? Cilat institucione përfshihen në proces?

Procesi i harmonizimit të legjislacionit maqedonas me atë të Bashkimit Evropian, në fushën e bujqësisë udhëhiqet nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit me ujëra. Ajo i përcakton prioritetet afatshkurta dhe afatgjate të procesit dhe i harton planet vjetore në kuadër të Programit nacional për marrjen e legjislativës evropiane.

Çdo vit, Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit me ujëra i përcakton rregullativat evropiane që do të kenë prioritetet gjatë marrjes në legjislacionin maqedonas. Në kuadër të këtij procesi, Ministria i analizon ndryshimet e nevojshme dhe nevojën për krijimin ose përforcimin e institucioneve të caktuara, në drejtim të përkrahjes së legjislacionit të ndryshuar. Përveç Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit me ujëra, në proces përfshihen edhe të gjitha organet tjera të Ministrisë, organizatat administrative dhe entet profesionale dhe shkencore që punojnë në fushën e bujqësisë.

52 Si mund të jetë bujku i jonë konkurrent në atë evropian?

Bujku i Maqedonisë sot nuk ka aftësi të zhvilluar konkurrencte, krahasuar me bujqit e shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, përforcimi i shpejtë i aftësisë konkurrencte të bujqve tonë ka rëndësi kyçe për integrimin e suksesshëm në tregun e përbashkët evropian, ku janë mënjanuar të gjitha barrierat doganore dhe tjera tregtare. Bujku i

Maqedonisë i ka përjetuar me sukses presionet dhe problemet e tranzicionit. Madje edhe anëtarësimi në Organizatën botërore tregtare dhe shumë marrëveshje tjera për tregti të lirë nuk kanë mund të ndikojnë në kushtet natyrore për prodhimin e qëndrueshëm bujqësor, në pothuajse të gjitha zonat, madje edhe në rrethana të konkurrencës në rritje.

Në Republikën e Maqedonisë, çdoherë e më shumë veprimtari bujqësore specializohen në prodhimtarinë e prodhimeve të ndryshme dhe kanë konkurrencë të lartë. Megjithatë, edhe në këto ekonomi, për sigurimin e zhvillimit të mëtejshëm nevojitet aftësimi i vazhdueshëm i kërkesave të tregut - kjo do të thotë shumë dituri, inovacione dhe investime. Çdo bujq që dëshiron të mbesë në treg dhe ta përforcojë konkurrencën, duhet t'i merr parasysh këto kushte dhe të punojë për plan afarist, me të cilin do të bashkohen këto elemente:

- ▶ zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- ▶ dallimi i prodhimit ose shërbimit - çmimi adekuat, cilësia, vijueshmëria dhe fleksibiliteti i ofertës;
- ▶ bashkëpunimi me prodhuesit tjerë;
- ▶ integrimi në zinxhirin e prodhimit dhe konsumit;
- ▶ të hyrat shtesë përmes bujqësisë shumë-shtresore.

53 A do të jetë e nevojshme për bizneset bujqësore të kenë ndonjë madhësi të caktuar pas anëtarësimit në BE?

Mesatarisht, ekonomia bujqësore në shtetet-anëtare të BE-së lëviz prej 3,5 ha në Qipro deri në 67 ha. Kjo tregon që për qëndrueshmërinë e ekonomive bujqësore në BE nuk është vendimtare madhësia, por konkurrenca e prodhimit, oferta adekuate, organizimi dhe qasja gjegjëse në treg.

Duke e marrë parasysh madhësinë mesatare të ekonomive bujqësore në Republikën e Maqedonisë - mes 2,5 ha dhe 2,8 ha dhe parcelizimin e brendshëm prej 0,3 ha deri në 0,5 ha, rritja e madhësisë së sipërfaqeve të mbjella është një prej pjesëve kryesore të reformës së politikës bujqësore. Në aspekt të përkrahjes së reformave strukturore, ndërmerren aktivitete për krijimin e kadastrës bashkëkohore dhe regjistrin të ekonomive bujqësore, si dhe masave tjera për konsolidimin e tokës bujqësore. Përvojat nga shtetet e BE-së tregojnë që reforma bujqësore dhe rritja e ekonomive bujqësore nuk është e thjeshtë dhe as proces i shpejtë - në disa shtete-anëtare janë nevojitur disa dhjetëvjeçare për përfundimin e procesit.

Kuptohet, si pjesë e procesit duhet të konsiderohet edhe ndryshimi i strukturës së prodhimit, përmes së cilës mund të sigurohet fitim më i lartë për njësi-sipërfaqe, si dhe ekzistim për ekonominë bujqësore.

54 Si do të ndikojë anëtarësimi në Bashkimin Evropian në të ardhurat e bujqve?

Në ndryshimin e të hyrave të bujqve, ndikon Politika e përbashkët doganore e BE-së, ndryshimi i strukturës së prodhimtarisë bujqësore dhe shuma e përkrahjes financiare, si dhe ulja e intervenimeve shtetërore në bujqësi deri në masën ku mundësohet ose masën e lejuar nga legjislacioni i BE-së në pjesën e bujqësisë. Secili faktor i cekur mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ në sektorët e caktuar, kështu që është e qartë që në disa sektorë, anëtarësimi në BE nuk do t'i sjellë ndryshime të njëjta të të ardhurave secilit bujk.

Bujqit e Maqedonisë do të mund të llogarisin edhe më tej në mbështetjen e shtetit, në drejtim të përmirësimit të konkurrencës, por me shfrytëzimin e mjeteve të fondeve para-anëtarësimi të BE-së, ndihma do të rritet. Veçanërisht do të rritet përkrahja për investimet në modernizimin e ekonomive bujqësore. Më tej, rritja e fondeve për përkrahjen e zhvillimit rural do të kontribuojë për diversifikimin e ekonomive bujqësore, për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme dhe përmirësimin e konkurrencës së mbarë sektorit.

Në treg me 480 milionë banorë, nuk ka dyshim që konkurrenca është e madhe. Por, integrimi do të rezultojë edhe me rritjen e të hyrave, përmes zhvillimit gradual të prodhimtarisë së qëndrueshme, në kuadër të Politikës së përbashkët bujqësore. Përvoja nga ndryshimet e të hyrave në 10 shtetet-anëtare që u anëtarësuan në BE në vitin 2004, jep përfundimin që pas anëtarësimi në BE, bujqit e Maqedonisë do të mund të presin rritje të të ardhurave.

55 Kush vendos çka është dhe çka nuk është rentabile të prodhohet në Bashkimin Evropian?

Vendimi për atë se çka është rentabile dhe çka jo në Bashkimin Evropian nuk merret në institucionet evropiane, as në shtetet-anëtare. Si edhe në të kaluarën, sot është më se e sigurt se vendimi për atë çka është rentabile dhe çka jo diktohet nga tregu, gjegjësisht konsumatorët. Për shkak të specifikave të prodhimtarisë bujqësore, edhe më tej pritet pjesëmarrja e shtetit, në kuptim të përkrahjes ose krijimit të kornizës që do të hapë hapësirë për krijimin e bujqësisë së qëndrueshme, që do të jetë adekuate me kërkesat e tregut dhe do të kujdeset për mjedisin jetësor.

Së këndejmi, është posaçërisht e rëndësishme të kuptohet që vendimi për zgjedhjen e prodhimeve që do të prodhohen është mbi të gjitha - vendim i bujkut. Ai duhet ta planifikojë prodhimin, varësisht nga gjendja e tregut dhe kërkesa e ndonjë prodhimi të caktuar, gjegjësisht sipas mundësisë së bujkut për ofrimin e prodhimit me cilësi dhe çmim të caktuar në treg. Të gjitha hulumtimet tregojnë që shtetet e vogla, si që është Republika e Maqedonisë, mund të inkuadrohen në tregun evropian më së miri përmes ekskluzivitetit të prodhimit të prodhimeve ushqimore, me cilësi të jashtëzakonshme dhe prodhime ekologjike të prodhuesve të njohur.

56 Kush e rregullon kufirin minimal dhe maksimal të çmimeve të prodhimeve bujqësore në Bashkimin Evropian?

Kufiri maksimal i çmimeve të prodhimeve përcaktohet nga tregu, gjegjësisht blerësit. Kjo do të thotë që prodhuesi mund ta diktojë çmimin e prodhimit deri në kufirin që mund të tolerohet nga blerësi. Nga ana tjetër, kufiri minimal përcaktohet nga shpenzimet e prodhimitarisë. Në raste të caktuara, tek disa prodhime, kufiri minimal mbrohet me çmime intervenente.

Në përgjithësi, çmimi i tregut është më i lartë se çmimi i interventit, meqë sistemi i interventit në Bashkimin Evropian nuk është dizajnuar për stimulimin e prodhimitarisë së prodhimeve për të cilat nuk ka vend në treg, në kushte normale. Thënë ndryshe, kjo do të thotë që bujqit nuk duhet të mbështeten në blerjen e interventit, por gjatë planifikimit duhet t'i përcjellin lëvizjet në treg dhe ta përshtasin prodhimtarinë ndaj kërkesës, nëse dëshirojnë të jetë rentabile përsëri.

Për prodhimet e caktuara (mishi i lopës, sheqeri, qumështi dhe prodhimet e qumështit), bujqit e BE-së mund të llogarisin edhe në mbrojtjen doganore ndaj shteteve të treta, që ndikon në kufirin minimal të tregut të BE-së, të jetë dukshëm më i lartë se çmimet botërore. Me siguri që anulimi i plotë i mbrojtjes doganore në BE nuk do të ndodhë në 10 vitet e ardhshme - nëse Republika e Maqedonisë anëtarësohet në BE në këtë periudhë, bujqit do të kenë mundësi ta shfrytëzojnë përparësinë e kësaj mase mbrojtëse.

57 Si funksionon sistemi i pagesave direkte në Bashkimin Evropian?

Politika e përbashkët bujqësore e Bashkimit Evropian e aplikon sistemin e pagesave direkte (shtylla e parë) dhe sistemin e përkrahjes së zhvillimit rural (shtylla e dytë).

Rregullativat me të cilat përcaktohet sistemi i përkrahjes së politikës së përbashkët bujqësore e parashohin pagesën unike sipas ekonomisë bujqësore, si përkrahjen e prodhimitarisë. Pagesa unike sipas ekonomisë mund të realizohet nga bujqit, pa dallim nga dega në të cilën janë aktivë, madje edhe nëse vendosin të mos jenë aktivë. Por, realizimi i pagesës unike për ekonomi bujqësore lidhet edhe me respektimin e dispozitave që lidhen me mirëqenien e kafshëve, sigurinë e ushqimit, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njerëzve.

Shuma e pagesës unike që mund ta realizojë një bujk përcaktohet kështu: mesatarja trevjeçare (për shembull 2007-2009) e të gjitha mjeteve që i ka fituar si përkrahje ndahet në mesatare trevjeçare, për të gjithë hektarët e tokës për të cilët ka pranuar përkrahje në periudhën e cekur.

58 Çka është IPARD dhe si funksionon Agjencia për IPARD?

Duke e kuptuar që ekziston zhvillimi i pabarabartë i shteteve në procesin e stabilizim-asociimit dhe që ato nuk janë harmonizuar me politikën e përbashkët bujqësore, Komisioni Evropian e ka dizajnuar Instrumentin për ndihmë para-anëtarësimit (IPA),

duke e zhvilluar edhe komponentën përmes së cilës do të përkrahjet zhvillimi rural dhe bujqësia.

Komponenta për zhvillim rural (komponenta 5) ka të bëjë me shtetet-kandidate dhe mund të shfrytëzohet vetëm prej tyre, si që është Republika e Maqedonisë, Kroacia dhe Turqia. Shfrytëzimi i mjeteve të komponentës së pestë, megjithatë nuk varet vetëm nga statusi i shtetit në proces, por edhe nga ekzistimi i kapaciteteve administrative dhe tjera në shtet. Kapacitetet administrative e nënkuptojnë edhe agjencinë e pavarur, që do t'i menaxhojë mjetet e fituara sipas rregullave dhe procedurave, që janë adekuate me ato të Bashkimit Evropian. Rregullat dhe procedurat për menaxhimin e mjeteve të komponentës së pestë janë aprovuar dhe agjencia është akredituar nga Komisioni Evropian për ushtrimin e punës.

Në Republikën e Maqedonisë, agjencia quhet Agjencia për përkrahjen financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Por, meqë i menaxhon mjetet e komponentës së pestë, IPARD njihet si Agjencia IPARD. Kjo agjenci është themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, por është organ i pavarur, meqë nuk është pjesë e organizimit qeveritar, gjegjësisht Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe ekonomizim me ujëra. Agjencia IPARD i ka miratuar dokumentet themelore programore dhe dokumentet tjera të planit dhe i ka realizuar procedurat për menaxhim dhe shpërndarjen e mjeteve, kurse tani e pret akreditimin nga Komisioni Evropian.

59 Cilat fusha kanë prioritet për financim përmes IPARD-it?

Prioritetet e përcaktuara për shpërndarjen e mjeteve dhe financimin përmes komponentës së pestë të IPA (IPARD), korrespondon me dy shtyllat

e politikës së përbashkët bujqësore të Bashkimit Evropian. Konkretisht, prioritetet e përcaktuara lidhen me:

1. Adaptimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së:

- ▶ investimi në ferma, me qëllim të ristrukturimit dhe përmirësimit;
- ▶ investimi në përpunim dhe marketingu i prodhimeve bujqësore;
- ▶ përkrahja e themelimit të grupeve të prodhuesve;
- ▶ disajnimi i metodave prodhuese bujqësore, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ruajtjes së peizazheve natyrore;

2. Zhvillimin e zonave rurale:

- ▶ përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rurale;
- ▶ zhvillimi dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike bujqësore;
- ▶ përgatitja e bashkësive rurale për fillimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillim rural;
- ▶ përmirësimi i trajnimit të bujqve.

60 Si definohet prodhimi i ushqimit të shëndoshë në Bashkimin Evropian, gjegjësisht cilat kushte duhet të plotësohen nga prodhuesit e këtij ushqimi?

Çdo prodhim ushqimor i prodhuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për siguri të ushqimit dhe Rregullores për shënimin e ushqimit është ushqim i shëndoshë. Ligji për siguri të ushqimit është i harmonizuar në masë të madhe me Rregullativën e Parlamentit Evropian dhe Këshillin për rregullsinë shëndetësore të ushqimit.

Problemi me të a.q. siguri të ushqimit, që e nënkupton rregullsinë shëndetësore të ushqimit, në kohët e fundit diskutohet në nivelet më të larta të Bashkimit Evropian dhe Organizatës shëndetësore botërore, por edhe organizatat tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ushqimin. Fatkeqësisht, shumë bujq tonë dhe shumë persona të industrisë ushqimore nuk kanë njohuri të mjaftueshme për Ligjin dhe Rregulloren. Rregullat e BE-së janë shumë të rrepta dhe të qarta për këtë çështje.

61 A mund të theret/vritet kafsha në Bashkimin Evropian pa u futur në gjumë paraprakisht?

Legjislacioni i Bashkimit Evropian që lidhet me therjen dhe vrasjen e kafshëve e synon zvogëlimin deri në masën maksimale të mundshme të dhembjes, lëngimit dhe shqetësimit të kafshës para therjes, duke i aplikuar metodat e përcaktuara shkencore dhe praktike.

Me direktivat e BE-së përcaktohen kushtet për therjen e kafshëve në thertore, por edhe jashtë, si dhe vrasja e kafshëve - kur lejohet jashtë thertoreve, si masë e kontrollit të sëmundjeve ngjitëse, në industrinë e lëkurës, etj.

Gjatë të gjitha veprimeve të therjes ose vrasjes së kafshëve, duhet të veprohet në mënyrë që e kursen kafshën nga shqetësimi, frika, dhembja ose lëngimi i mëtejshëm. Kuadri i thertoreve duhet të ketë njohuri dhe aftësi të posaçme profesionale, për ta kryer therjen e kafshëve në mënyrën e përcaktuar.

Therja dhe vrasja e kafshëve jashtë thertoreve përcaktohet dhe rregullohet në mënyrë mjaft të kufizuar dhe vetëm në raste të kufizuara, për shembull, si masë për ndalimin e sëmundjeve ngjitëse, në industrinë e lëkurës ose ushqimit.

62 Çka ndodh me mishin- mbeturinë në Bashkimin Evropian?

Mishi që nuk mund të shfrytëzohet për ushqimin e njerëzve, për shkak të rrezikut dhe origjinës, shkatërrohet në ndonjë prej mënyrave të përcaktuara: me përpunim termik ose me aprovimin e organit kompetent - me incineracion.

63 Si përcillet cilësia e mishit në Bashkimin Evropian? Çka është sistemi për regjistrimin dhe përcjelljen e kafshëve në Bashkimin Evropian?

Për gjedhin në Bashkimin Evropian - lopët, derrat, dhitë, derrat, kuajt dhe kafshët shtëpiake, janë zhvilluar sistemet e ndryshme për identifikimin dhe regjistrimin, me të cilat mundësohet përcjellja e lëvizjes së tyre, kontrollin veterinar, ndalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe siguria e ushqimit dhe konsumatorit.

Për llojet e ndryshme të gjedhit parashihen sisteme speciale që mund ta përfshijnë:

- ▶ shënimin e kafshëve (pullat në vesh dhe/ose numrat individualë për çdo kokë, instalimi i çipave për kafshët shtëpiake);
- ▶ regjistri i të gjitha ekonomive bujqësore, gjegjësisht kultivuesve;
- ▶ pasaportat për çdo kokë;
- ▶ dokumentacioni i paraparë për eksport, import dhe transport të gjedhit;
- ▶ baza kompjuterike e të dhënave në nivel nacional.

64 Si do të ndikojë anëtarësimi në Bashkimin Evropian në blegtori?

Blegtorja është degë me rëndësi të veçantë bujqësore në BE, që realizohet në kushte të tregut të hapur. Tregu për këtë fushë rregullohet me dispozita që sigurojnë pozitë stabile të prodhimit blegtoral në kushte të tregut të hapur botëror. Rregullimi i tregut dhe kushteve tregtare e nënkupton përcaktimin e kushteve ku lejohet intervenimi në treg, në raste të mbingarkesës nga prodhimet e shumta. Vëmendje e posaçme i kushtohet edhe kontrollit të importit dhe inkurajimit të eksportit. Me masa të shumta të përkrahjes direkte dhe indirekte për blegtorinë sigurohet edhe konkurrenca në treg.

Këto përparësi do t'i gëzojë edhe blegtorja maqedonase pas anëtarësimit në BE, përveç gëzimit të përparësive nga tregu i përbashkët evropian. Kup-tohet, këtu duhet të merret parasysh fakti që paraprakisht duhet të arrihet një nivel i konkurrencës në raport me blegtorët e BE-së. Arritja e konkurrencës është masë afatgjate, për të cilën blegtorët e Maqedonisë duhet të përgatiten që sot. Së këndejmi, duhet të inkurajohet krijimi i njësive prodhuese, duke e marrë parasysh madhësinë e fermës; teknologjitë e aplikuara për prodhim; veçoritë gjenetike të kafshëve të kultivuara, si dhe niveli i arritur për njësi - këto do të sigurojnë rezultate të njëjta të prodhimit, si në fermat e ngjashme të shteteve tjera.

65 Cilat janë kushtet për mbjelljen e vreshtave të reja të verës në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian dhe çfarë dokumentacioni nevojitet?

Në pajtim me Rregullativën e Komisionit Evropian, mbjellja e vreshtave të reja në shtetet-anëtare të BE-së ndalohet deri më 31.06.2010. Parashihen disa përjashtime, në kushtet e përcaktuara saktë, por Komisioni Evropian nuk i përcakton dokumentet e nevojshme për marrjen e lejes.

66 A mund të vazhdohet me pjekjen e rakisë nga prodhuesit maqedonas pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian?

Legjislacioni në BE nuk e rregullon prodhimin e pijeve alkoolike për përdorim personal, por legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve është tejtejt i rreptë dhe përmban shumë dispozita që duhet të respektohen nga prodhimet e caktuara, kur shiten në treg, përfshirë edhe pijet alkoolike.

Si përfundim - edhe më tej do të mundësohet prodhimi i pijeve alkoolike për përdorim shtëpiak, por shitja e tyre do ta nënkuptojë plotësimin e rregullave gjegjëse për cilësi dhe deklarim.

67 Si trajtohet bletaria nga Bashkimi Evropian?

Në Evropë, madje edhe në botë, prodhimi i mjaltës dhe prodhimeve të bletarisë shënon rritje. Por, edhe më tej trajtohet si deficitare. Shtetet-anëtare të BE-së nuk i plotësojnë nevojat nga prodhimtaria vetanake, kështu që BE është importuesi më i madh i mjaltës dhe prodhimeve të bletarisë.

Për ta rritur prodhimtarinë e mjaltës dhe prodhimeve të bletarisë, Bashkimi Evropian e inkurajon prodhimtarinë përmes bashkë-financimit me programet nacionale për zhvillimin e bletarisë në shtetet-anëtare, deri në 50% të investimit. Programet nacionale për zhvillimin e bletarisë duhet t'i përcaktojnë saktë masat që do të financohen, si dhe masat për kontrollin e realizimit të programit.

POLITIKA E PËRBASHKËT PËR MJEDIS JETËSOR

68 Në çfarë mase është harmonizuar legjislacioni maqedonas i mjedisit jetësor me legjislacionin e Bashkimit Evropian?

Komisioni Evropian ndërmerr aktivitete për përcjelljen e procesit të marrjes së legjislacionit evropian për mjedisin jetësor në legjislacionin nacional të Republikës së Maqedonisë. Procesi është pjesë e obligimeve të Republikës së Maqedonisë, që rrjedhin nga Marrëveshja për stabilizim dhe asociim.

Duke e vijuar avancimin në proces, Komisioni ka konstatuar që legjislacioni maqedonas për mjedis jetësor është dakorduar me atë evropian në mbi 60%, ku afati final për arritjen e harmonizimit të plotë është viti 2015, gjegjësisht 2020 për disa rregullativa evropiane. Kur flitet për zbatimin e legjislacionit të ri ose të harmonizuar, Republika e Maqedonisë duhet të bëjë edhe shumë. Suksesi do të varet nga shfrytëzimi i drejtë i ndihmës financiare nga BE-ja, si dhe instrumentet tjera të kapshme në proces, por edhe nga suksesi i procesit për bisedimet për anëtarësim.

69 Si rrjedh procesi i harmonizimit të legjislacionit dhe cili institucion është kompetent për udhëheqjen e procesit? Cilat institucione përfshihen në proces?

Procesi i harmonizimit të legjislacionit maqedonas me legjislacionin e BE-së në fushën e mjedisit jetësor udhëhiqet nga Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, e cila i përcakton prioritetet afatshkurta dhe afatgjate të procesit dhe i harton planet vjetore në kuadër të Programit nacional për marrjen e legjislacionit evropian.

Çdo vit, Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor i përcakton rregullativat evropiane që do të kenë prioritet për marrje nga legjislacioni i Maqedonisë. Në kuadër të këtij procesi, Ministria e bën analizën e ndryshimeve të nevojshme në legjislacionin maqedonas, si dhe analizën e nevojës për krijimin ose përforcimin e institucioneve të caktuara, në drejtim të përkrahjes së legjislacionit të ndryshuar. Përveç Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, në këtë proces përfshihen edhe të gjitha organet tjera të Ministrisë, organet tjera administrative dhe entet profesionale dhe shkencore që veprojnë në fushën e mjedisit jetësor.

70 A ekziston ndonjë sistem për kontrollin e ndikimit mbi mjedisin jetësor nga aktivitetet e caktuara të aprovuara ose planifikuara në natyrë?

Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor është vetëm një pjesë e procesit të ndërmarrjes së aktiviteteve të caktuara që janë aprovuar ose planifikuar në natyrë. Në pajtim me legjislacionin evropian, gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të aprovuara, në kuadër të projekteve të caktuara, vlerësohet ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe natyrën. Raporti për vlerësimin e realizuar është kusht pa të cilin nuk mund të realizohet aktiviteti - vetëm raporti pozitiv mund ta sigurojë marrjen e lejes dhe realizimin e aktivitetit të caktuar. E njëjta vlen edhe për dokumentet strategjike ose të planit dhe për ndikimin që e kanë në mjedisin jetësor, gjegjësisht në natyrë. Dallimi i vetëm në këtë rast, është në faktin që vlerësimi i ndikimit të dokumentit strategjik ose të planit, vlerësimi i gjendjes është pjesë përbërëse e dokumentit dhe ajo propozon aktivitete gjegjëse për zbutjen e ndikimit mbi natyrën.

Ligji për mjedis jetësor i Republikës së Maqedonisë tashmë i ka ndërmarrë dy aktet kryesore juridike të Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe ka arritur harmonizim të plotë. Bëhen përpjekje serioze për zbatimin e plotë të dispozitave ligjore.

71 Si kam mundësi unë, si qytetar, të ndikoj në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor?

Secili qytetar ka të drejtë të pjesëmarrjes aktive në miratimin e vendimeve që ndikojnë në mjedisin jetësor, veçanërisht gjatë miratimit të legjislacionit për mjedisin jetësor. Kjo e drejtë rregullohet me Konventën e Arhusit, si dhe me Direktivën e BE-së për qasje ndaj informatave të mjedisit jetësor.

Kjo direktivë, si dhe konventa ndërkombëtare, janë bartur në Ligjin për mjedis jetësor. Në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor, si dhe me legjislacionin tjetër që i rregullon sektorët gjegjës të fushës, pjesëmarrja publike është pjesë e çdo procedure për miratimin e ligjeve dhe akteve tjera juridike. Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor është e obliguar që në procesin e miratimit të ligjeve dhe akteve tjera të organizojë diskutim publik me qytetarët, që të njihen më mirë me propozimin dhe të japin propozimet e tyre për përmirësim.

72 Në çfarë mënyre kontribuon legjislacioni i BE-së për mjedis jetësor në përmirësimin e cilësisë së ajrit?

Bashkimi Evropian i përkushton vëmendje të posaçme cilësisë së ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, përmes përmirësimit të cilësisë së ajrit. Ekzistojnë disa akte juridike të Bashkimit Evropian, me të cilat përpiqet që me përcaktimin e standardeve të ndryshme për lëshimin e materieve të dëmshme në ajër ose gazrave, të arrihet cilësia më e mirë e ajrit ambiental.

Legjislacioni evropian parasheh sistem për përcaktimin e zonave dhe këndmatësve, kufijve minimalë dhe maksimalë për lëshimin në ajër, si dhe katalogun e ndotësve, ku shënohen llojet e ndotësve dhe substancave me të cilat e ndotin ajrin. Me këtë legjislacion përcaktohen edhe rregullat për tregti të emisioneve, me të cilat sigurohet ulja e tyre, realizimi i parimit që ndotësi paguan dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit.

73 A do të përdorim karburante më të mira evropiane, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian?

Cilësia e ajrit ka rëndësi të veçantë për Bashkimin Evropian, kurse ndotja e burimeve të lëvizshme, si që janë veturat në shoqërinë e industrializuar, zhvillimi i të cilës bazohet pikërisht në transportin dhe lidhjet, është e jashtëzakonshme. Për këtë arsye ekziston nevoja që BE ta rregullojë shfrytëzimin e karburanteve - BE e përcakton cilësinë e karburanteve në aspekt të përmbajtjes së plumbit, gjegjësisht sulfurit, për të ndikuar në mënyrë indirekte në cilësinë e ajrit ambiental.

Së këndejmi, arritja e harmonizimit të plotë me legjislacionin e BE-së do t'i sjellë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë karburante më të mira evropiane për makinat e tyre.

74 Cilat janë rregullat për hedhjen e mbeturinave të bujqësisë?

Menaxhimi i drejtë me mbeturinat fillon nga parandalimi i krijimit të mbeturinave. Në rastet kur nuk mund të ndalohej krijimi i mbeturinave, rregullat parashohin që ai të reduktohet. Pas krijimit, mbeturinat duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe pastaj të mënjanohen.

Gjatë trajtimit të mbeturinave organike, ato mund të kompostohen ose shfrytëzohen për fitimin e prodhimit të ri. Si trajtim final i mbeturinave mund të pranohet djegia ose incinerimi, gjegjësisht prolongimi me të cilin do të ketë ndikim më të ulët në mjedisin jetësor.

75 A do të lejohet hedhja e kripës dhe zallit në rrugë gjatë dimrit, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian?

Sipas rregullave më të reja të Bashkimit Evropian, hedhja e kripës dhe zallit në rrugë gjatë dimrit, me qëllim të parandalimit të ngricave ose qëndrimit të borës, mbetet e lejuar. Por, kjo nuk do të thotë që mund të hedhet çfarëdo lloji i kripës, gjegjësisht zallit.

Bashkimi Evropian kërkon që zalli që hedhet në rrugë të plotësojë standarde të caktuara në aspekt të përbërjes, që të mos ndikojë në cilësinë e ajrit ambiental.

76 A ndalohet mihja e puseve për furnizim me ujë nga legjislacioni evropian për cilësinë e ujit?

Uji është burim natyror dhe baza e jetës. Posedimi i ujit të pastër të pijes është me rëndësi të veçantë dhe supozohet që rëndësia do të rritet me zvogëlimin e burimeve të ujit të pastër për pije.

Bashkimi Evropian nuk ka problem me mihjen e puseve për furnizim me ujë, gjegjësisht me shfrytëzimin e ujit për furnizim individual. Megjithatë, BE parasheh realizim të parimit ku konsumatori paguan, sipas të cilit shfrytëzimi i ujit të puseve për shfrytëzim individual nuk e nënkupton pagesën e kompensimit, por shfrytëzimi i ujit për nevojat e prodhimit do të nënshtrohet pagesës së kompensimit të caktuar. Për shembull, një familje në Maqedoni furnizohet me ujë të pijshëm nga pusi në oborrin e tyre dhe nuk paguan për ujin e shfrytëzuar. Birraria e Shkupit e shfrytëzon ujin e puseve të birrarisë për prodhimin e birrës. Ky shfrytëzim, sipas parimit ku shfrytëzuesi paguan, do të nënshtrohet pagesës së kompensimit.

77 A do të nevojitet mbrojtja e popullatave të ujëve pas anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian?

Ujku është lloj i egër i mbrojtur në Bashkimin Evropian dhe gjendet në listën e anekseve të Direktivës së llojeve të egra dhe vendbanimeve të tyre. Së këndejmi, në momentin kur Republika e Maqedonisë do të anëtarësohet në BE, ujku do të jetë

lloj i mbrojtur. Megjithatë, në procesin e negociatave për anëtarësim, Republika e Maqedonisë mund të kërkojë lirim nga obligimi i mbrojtjes së ujëve, gjegjësisht zvogëlim të kategorisë me të cilën ujku mbrohet në shtetin tonë si lloj i mbrojtur dhe mund të sigurojë kontroll të popullatës së ujëve.

78 Çka parasheh Bashkimi Evropian për zonat e mbrojtura?

Duke e synuar mbrojtjen e natyrës së saj, Bashkimi Evropian e rregullon mbrojtjen e vendbanimeve natyrore dhe krijimin e korridoreve për lidhjen e tyre. Me sistemin e këtitillë të korridoreve dhe vendbanimeve, BE siguron edhe qarkullim të shumëllojshmërisë biologjike dhe këmbim të materialit gjenetik, mes tjerash.

Duke e përcaktuar sistemin e zonave të rëndësishme ekologjike, BE parasheh disa masa dhe aktivitete që duhet aplikuar për arritjen e mbrojtjes së vendbanimeve për llojet e egra, në vendbanimet e tyre. Përveç sistemit të cekur, BE e pranon edhe sistemin e krijuar nga Unioni ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës, që parasheh mbrojtje më të gjerë të proceseve të mëdha ekologjike në zonat e mëdha të mbrojtura.

79 Pse në Republikën e Maqedonisë nuk ka më shumë zona të mbrojtura, të shpallura në kategorinë Park nacional?

Tradita e mbrojtjes së zonave në kategorinë park nacional rrjedh që nga viti 1948, kur në Republikën e Maqedonisë është shpallur parku i parë nacional në ish-RSFJ-në - Pelisteri. Deri tani, në territorin e vendit tonë janë shpallur 3 parqe nacionale - Pelisteri, Mavrova dhe Galiçica. Ekzistojnë edhe shumë zona tjera të mbrojtura, të cilat në kategori të ndryshme japin mbrojtje për llojet, vendbanimet ose proceset ekologjike, të rëndësishme për Maqedoninë, Evropën dhe botën.

Sipas llogaritjeve të Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, rreth 7% e territorit të vendit është zonë e mbrojtur në këtë moment. Strategjia për shumëllojshmëri biologjike parasheh rritje të përqindjes së territorit të zonave të mbrojtura, deri në maksimum 14%. Në kuadër të 7% tjera hyjnë edhe tre parqe tjera nacionale, si për shembull “Mali Sharr”, “Jabllanica” dhe “Bellasica”.

80 A e mundëson mbrojtja e liqeneve natyrore (të Ohrit, Prespës dhe Dojranit) si monumente të kulturës, dhënien me koncesion të ujërave dhe faunës së egër të liqeneve?

Shpallja e ndonjë rajoni si zonë të mbrojtur, gjegjësisht monument natyre, e supozon edhe ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje

dhe menaxhim. Zona shpallet si zonë e mbrojtur për shkak të veçorive natyrore ose ndikimit të posaçëm në shumëllojshmërinë natyrore. Pasuria e llojeve e jep mundësinë e shfrytëzimit të tyre, por kjo duhet të jetë në drejtim të ruajtjes së numrit të popullatës në vendbanimin natyror.

Prej këtu rrjedh edhe qëllimi i ligjvënësit për përcaktimin e subjektit që kujdeset për menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të parapara për mbrojtje, në vend të koncesionimit të burimeve natyrore ndaj personave të tretë.

81 Kush duhet të menaxhojë me plazhet e Liqenit të Ohrit?

Legjislacioni pozitiv në Republikën e Maqedonisë parasheh që plazhet e Liqenit të Ohrit të jepen me koncesion për menaxhim dhe mirëmbajtje. Por, plazhet në pjesën prej te hoteli “Granit” deri në kufirin me Republikën e Shqipërisë tek manastiri Sh. Naum janë pjesë e Parkut nacional “Galiçica” dhe në këtë rast, menaxhimi me plazhet përcaktohet nga Ligji për mbrojtjen e natyrës.

Sipas këtij ligji, menaxhimi me territorin e parkut bëhet nga Enti publik Parku nacional, i cili menaxhon me tërë territorin, në mënyrë integrale, në pajtim me Ligjin. Në këtë territor nuk lejohet koncesionimi i plazheve ndaj personave të tretë.

82 A mund të ruaj kafshë të egra si pre dhe kush i përcakton kushtet për këtë?

Ruajtja e llojeve të egra si pre përcaktohet nga Ligji për mbrojtjen e natyrës dhe aktet nënligjore, që i rregullojnë kushtet që duhet plotësuar nga personi që ruan ndonjë lloj të egër, si dhe kushtet që duhet t'i përmbushë vendbanimi. Në BE, kushtet për ruajtjen e kafshëve si pre përcaktohen nga Direktiva për kopshtet zoologjike, që i referohet standardeve të përcaktuara me rregulloret e Asociacionit evropian për kopshtet zoologjike dhe akuariumet.

Sipas këtyre rregullave, në Republikën e Maqedonisë lejohet ruajtja e llojeve të egra si pre, vetëm nëse plotësohen kushtet e parapara dhe nëse kafshëve i mundësohen kushtet e përafërta natyrore në vendin e banimit.

83 A e nënkupton harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit ekologjik të Bashkimit Evropian edhe ndihmën financiare dhe cilat janë instrumentet e kësaj ndihme?

Përshtatja dhe zbatimi i legjislacionit natyror të BE-së është aktiviteti më i shtrenjtë që duhet të ndërmerret nga shtetet-anëtare, si dhe shtetet-kandidate dhe kandidatët potencialë. Për këtë arsye, BE-ja parashihet ndihmë adekuate financiare për ndërmarrjen e aktiviteteve të cekura.

Për shtetet-anëtare, BE e ka zhvilluar Fondin evropian për zhvillim rajonal, si dhe Fondin koheziv evropian, përmes të cilave përkrahen përpjekjet për

përshtatjen dhe aplikimin e legjislacionit ekologjik. Për shtetet-kandidate dhe kandidatët potencialë, BE e ka krijuar instrumentin për ndihmë para-anëtarësimit (IPA), si dhe komponentën që e ndihmon zhvillimin rajonal dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në fund, përveç dy instrumenteve të cekura financiare, të cilat janë të mëdha, BE e ka zhvilluar edhe programin e bashkësisë, të quajtur LIFE+, që konkretisht i përkrah aktivitetet për zbatimin e legjislacionit ekologjik dhe dokumenteve tjera strategjike, në pjesën e mbrojtjes së natyrës, shumëllojshmërisë biologjike, informimit dhe komunikimit.

Austria Belgium Bulgaria Cyprus Czech Republic Denmark Estonia Finland France Germany Greece Hungary Ireland Italy Latvia Lithuania Luxembourg Malta The Netherlands Poland Portugal Romania Slovakia Slovenia Spain Sweden United Kingdom Austria Belgium Bulgaria Cyprus Czech Republic Denmark Estonia Finland France Germany Greece Hungary Ireland Italy Latvia Lithuania Luxembourg Malta The Netherlands Poland Portugal Romania Slovakia Slovenia Spain Sweden United Kingdom Austria Belgium Bulgaria Cyprus Czech Republic Denmark Estonia Finland France Germany Greece Hungary Ireland Italy Latvia Lithuania Luxembourg Malta The Netherlands Poland Portugal Romania Slovakia Slovenia Spain Sweden United Kingdom Austria Belgium Bulgaria Cyprus Czech Republic Denmark Estonia Finland France Germany Greece Hungary Ireland Italy Latvia Lithuania Luxembourg Malta The Netherlands Poland Portugal Romania Slovakia Slovenia Spain Sweden United Kingdom Austria Belgium Bulgaria Cyprus Czech Republic Denmark

PUNËSIMI, LËVIZSHMËRIA, ARSIMI, TË RINJTË DHE KULTURA

84 Çka do të thotë “tregu i forcës së punës” së Bashkimit Evropian?

Parimi i lëvizjes së lirë të njerëzve është njëra prej lirive themelore të garantuara në BE. Si pjesë e lëvizshmërisë personale, lëvizshmëria e punës e përfshin të drejtën që çdo shtetas i BE-së të punojë dhe së bashku me anëtarët e familjes, të jetojë kudo në territorin e BE-së. Kjo do të thotë në praktikë që gjermani mund të punojë edhe në vendet tjera, si në Francë, Austri, Spanjë, etj (në cilindo shtet-anëtar të BE-së)..

85 A gjejnë të gjithë shtetasit e BE-së lehtë punë në vendet tjera-anëtare? A ka ndonjë përkrahje për këtë lëvizshmëri të punëtorëve?

Përvoja e deritashme e lëvizshmërisë së forcës së punës tregon që numri i qytetarëve që i shfrytëzojnë mundësitë e tregut të gjerë evropian edhe më tej mbetet i ulët, ndonëse përfitimet janë të mëdha. Për mënjanimin e pengesave ndaj lëvizshmërisë më të madhe të forcës së punës dhe me qëllim të kontributit për krijimin e tregut të vërtetë evropian të forcës së punës, BE zbaton politika të ndryshme

dhe zhvillon instrumente gjegjëse. Njëri prej tyre është EURES Network, rrjet i agjencive dhe shërbimeve nacionale të punësimin, që i mundëson qasje qytetarëve evropianë ndaj informatave për vendet e lira të punës në BE. Në këtë mënyrë, jo vetëm që motivohet lëvizshmëria e punëtorëve, por krijohet edhe harmonizimi më i mirë i ofertës dhe kërkesës së forcës së punës në tregun evropian.

86 A do të ndodhë dhe kur shtetasit e Maqedonisë do të mund të punojnë në cilindo shtet-anëtar të BE-së?

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë mund të konkurrojnë për punë dhe të punojnë në të gjitha shtetet-anëtare të BE-së me kushtet e njëjta si edhe shtetasit tjerë të BE-së, pas anëtarësimit të Maqedonisë në BE. Çdo shtetas i Maqedonisë do të ketë qasje në informatat e rrjetit EURES.

Ajo që mbetet e panjohur është nëse Maqedonia do ta ketë të a.q. periudhë kalimtare, ku tregu i punës mbetet i mbyllur për qytetarët e Maqedonisë. Vendosja për këtë do të varet nga perceptcionet e BE-së për ndikimin mbi tregjet nacionale të forcës së punës, por edhe nga aftësitë negociatore të vendit tonë.

87 A marrin shtetasit evropianë ndonjë ndihmë ose përkrahje për të udhëtuar dhe mësuar në shtetet tjera anëtare?

Po, janë zhvilluar disa skema për nxitjen e lëvizshmërisë për grupet e ndryshme: nxënësit dhe studentët, profesorët dhe trajnuesit, praktikantët dhe vullnetarët, shkencëtarët dhe hulumtuesit. BE vërtetë beson që arsimit dhe lëvizshmëria e qytetarëve të saj janë prioriteti më i lartë.

88 Cilat janë programet për përkrahje?

Programi për mësim të përjetshëm ka 4 nën-programe: Comenius, Erasmus, Leonardo da Vinci dhe Grundtvig, që dedikohen për nivelet e ndryshme arsimore. Për periudhën shtatëvjeçare 2007-2013, ky program ka buxhet prej pothuajse 7 miliardë eurove dhe përfshin mbi 6,5 milionë qytetarë evropianë.

89 Si do të ndikojë anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në BE mbi shpenzimet e shkollimit?

Në masë më të madhe, fusha e arsimit nuk rregullohet nga BE, por nga shtetet-anëtare. Kështu, procesi i integrimi evropian nuk duhet të ndikojë në shpenzimet arsimore. Ekziston tendenca e miratimit të standardeve-kornizë në nivel të BE-së, veçanërisht në sektorin e arsimit profesional dhe shkollimit të lartë. Miratimi i standardeve kornizë

(për arsimin profesional dhe të lartë), mund t'i rrisë shpenzimet e shkollimit në mënyrë indirekte, në kuptim të modernizimit dhe pajisjes së shkollave dhe programeve profesionale.

90 A do të shtrenjtohet arsimimi i fëmijëve pas anëtarësimi të Maqedonisë në BE?

Sipas dokumenteve strategjike të BE-së, rekomandohet rritja e investimeve në arsim dhe shkencë në BE, që nuk do të thotë rritje të shpenzimeve për shfrytëzuesit final, por arsim më cilësor në dispozicion të të gjithë qytetarëve.

91 Si e përshtat Republika e Maqedonisë sistemin e shkollimit të lartë ndaj sistemit të BE-së?

Reforma e sistemit të shkollimit të lartë në BE realizohet në kornizat e Procesit të Bolonjës, që parasheh pranim të shkallëve akademike dhe profesionale që njihen lehtë dhe janë të krahasueshme; krijimin e sistemit unik të studimit diplomik dhe pasdiplomik; promovimin e sistemit të pikëve (ECTS) me të cilin mund të mblidhen pikët gjatë mësimi të përjetshëm; nxitjen e lëvizshmërisë së studentëve dhe mësimdhënësve; inkurajimin e bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë në arsim. RM ka aderuar ndaj Procesit të Bolonjës, duke u obliguar për realizimin e qëllimeve të cekura. Kjo është reformë radikale, që ka për qëllim t'i integrojë sistemet arsimore të RM-së në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

92 Si do të organizohet arsimit i lartë në ardhmëri?

Arsimi i lartë ka rol themelor në shoqëri. Në Evropë ka rreth 4.000 institucione të arsimit të lartë me rreth 17 milionë studentë dhe 1.5 milionë të punësuar në këto institucione. Komisioni Evropian e ka futur reformën në tre fusha, në drejtim të krijimit të fushës së arsimit më të lartë evropian deri në vitin 2010. Reforma parasheh reforma në strukturën studimore (studimet diplomike, pasdiplomike dhe doktorale, njohja e programeve studimore dhe lëvizshmëria), reforma e menaxhimit (autonomia, partneritetet strategjike, cilësia e programeve studimore) dhe reforma e financimit (burimet e ndryshme të financimit, dhënia e granteve, huazimit, kompensimet e studimeve).

93 A do të jetë e mundur për shtetasit e Maqedonisë të lirohen nga pagesa e shkollimit në universitetet e BE-së?

Pas anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në BE, shtetasit do të mund të studiojnë në universitetet e BE-së me kushtet e njëjta si edhe shtetasit e shteteve-anëtare ku gjendet universiteti. Kjo do të thotë që studentët lirohen nga pagesa e shkollimit ose paguhet taksa e shkollimit që vlen për shtetasit e vendit ku gjendet institucioni i arsimit të lartë.

94 A do të rriten mundësitë për qarkullim të shtuar të shkencëtarëve?

Po, mundësitë për qarkullim më të madh të shkencëtarëve në BE do të rriten, për shkak se nuk do të ketë kufij, në kuptimin e tyre të sotëm. Në BE ka programe me të cilat nxitet lëvizshmëria dhe bashkëpunimi më i madh mes shkencëtarëve evropianë. Programet kornizë kanë për qëllim ta formojnë Hapësirën evropiane hulumtuese, me qëllim që më mirë të shfrytëzohen kapacitetet hulumtuese dhe përpjekjet që investohen në hulumtim dhe zhvillim në Evropë.

95 Çka nëse shumë shkencëtarë të Republikës së Maqedonisë ikin jashtë vendit?

Lëvizshmëria e rritur e shkencëtarëve konsiderohet si një prej kushteve më të rëndësishme për përmirësimin e shkencës dhe përforcimin e konkurrencës në hapësirën evropiane hulumtuese. Për këtë arsye inkurajohet ajo. Më tej, nxitet edhe kthimi i shkencëtarëve në vendet e tyre, përmes të a.q. "qarkullim të trurit". Por, problemi i ikjes së shkencëtarëve evropianë në vendet e treta nuk është i vogël. Për këtë arsye, programet kornizë për shkencë dhe zhvillim teknologjik në BE e inkurajojnë reintegrimin, gjegjësisht kthimin e hulumtuesve në BE.

96 Me cilin program mund të financohet arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm?

Nën-programi Comenius, pjesë e programit “Mësimi i përjetshëm” është relevant për këto anëtarë të bashkësisë arsimore: nxënësit, mësimdhënësit, pushtetet lokale, shoqatat e prindërve, organizatat joqeveritare, institucionet, universitetet, etj. Me nën-programin rritet lëvizshmëria e nxënësve dhe të punësuarve në arsim, nxitet partneriteti mes shkollave, inkurajohet mësimi i gjuhëve dhe teknologjive kompjuterike dhe telekomunikative, përmirësohet qasja pedagogjike dhe menaxhimi me shkollat. Me nën-programin Leonardo da Vinci financohen projektet në shkollat e mesme profesionale.

97 Me cilat programe mund të financohen projektet për arsimin universitar?

Me nën-programet Erasmus, Jean Monnet, Tempus dhe Erasmus Mundus (disa janë pjesë e programit “Mësimi i përjetshëm”), financohen projektet për arsimin universitar. Me programet ndihmohen nxënësit për studim, punë dhe mësim të gjuhëve jashtë vendit; ndihmohen të punësuarit e universiteteve dhe institucioneve për ligjërime dhe trajnim jashtë vendit; nxiten universitetet dhe institucionet për formimin e rrjeteve dhe pjesëmarrjes në projektet shumëpalëshe, dhe ndërmarrjet për gjetjen e vendeve të punës për punë praktike të studentëve, si dhe bashkëpunim me universitetet.

98 Me cilin program mund të financohen projektet për arsimin e të rriturve?

Me nën-programin Grundtvig (pjesë e programit “Mësimi i përjetshëm”) financohen projektet arsimore për të rriturit, të cilat e nxisin lëvizshmërinë dhe përfshijnë vizita, punë praktike, pjesëmarrje në projektet shumëpalëshe, pjesëmarrje në rrjetin e ekspertëve dhe organizative për zhvillimin e arsimit të të rriturve, etj.

99 Si marrin përkrahje studentët evropianë për studim në shtetet e ndryshme të BE-së?

Për 20 vite të ekzistimit, programi më i vjetër dhe më i njohur Erasmus i ka mundësuar pothuajse 2 milion evropianëve të rinj që një pjesë të arsimit universitar ta kalojnë jashtë vendit. Erasmus Mundus dhe Tempus janë programe të BE-së që e mbështetin lëvizshmërinë e arsimit të lartë mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të treta.

100 Si i përkrah shkencëtarët BE-ja?

Bursat Marie Curie i kanë mundësuar mijëra shkencëtarëve dhe hulumtuesve ta vazhdojnë punën e tyre jashtë vendit.

101 Po Maqedonia?! A mund të marrin përkrahje shtetasit e Maqedonisë përmes ndonjë programi?

Disa prej programeve të lëvizshmërisë edhe tani janë të hapura/kapshme për Maqedoninë. Kështu, programi Erasmus Mundus me nismën Western Balkans Window ofron 150 grante për studime post-diplomike evropiane në universitetet evropiane, kurse përmes nismës External Cooperation Window, jepen 600 grante për lëvizshmërinë e studentëve, hulumtuesve dhe kuadrit akademik nga shtetet e Ballkanit perëndimor, duke filluar nga viti 2008.

102 Hapja e kufijve për shkencëtarët, punëtorët, studentët dhe të rinjtë e sjell rrezikun për “ikjen e trurit”. A mund të ndalohen pasojat e rënda?

Mund të pritet që liberalizimi i tregut të forcës së punës në BE të shkaktojë ikje të forcës së punës nga Maqedonia, posaçërisht ikje të kuadrit të ri dhe me kualifikime të larta. Ikja e trurit (a.q. brain drain) është humbje e pasurisë/kapitalit njerëzor dhe intelektual, që i varfëron vendet nga ky burim i çmueshëm. Kushtet e punës dhe të ardhurat më të larta jashtë vendit janë arsye që shumë emigrues me kualifikime të larta të mbesin jashtë dhe ta kalojnë pjesën fitimprurëse së jetës në shtetet-pranuese, ku ka kushte më të mira pune. Por, problemi i ikjes së trurit nuk është i ri për Maqedoninë, ai ka histori më të gjatë. Në fakt, emigracioni i forcës së punës me kualifikim të lartë, posaçërisht shkencëtarëve

dhe hulumtuesve, është dukuri universale me të cilën ballafaqohet jo vetëm Maqedonia, por edhe Bashkimi Evropian.

103 A mund të parandalohen pasojat e rënda?

Bashkimi Evropian që moti e ka pranuar rëndësinë e kapitalit njerëzor në zhvillimin ekonomik, por edhe në zhvillimin e gjerë shoqëror, kështu që kushti dhe nevoja për investime të vazhdueshme është ngritur në nivel të prioritetet më të lartë strategjik. Investimet në potencialin e vet njerëzor, BE i kanalizon përmes instrumenteve dhe politikave të ndryshme. Kështu, projekti Hapësira hulumtuese evropiane i bashkon politikat dhe kapacitetet hulumtuese të shteteve-anëtare, kurse instrumenti i Programit të shtatë kornizë siguron financim të projekteve shoqërore dhe hulumtuese. Rrjeti evropian i qendrave për lëvizshmëri dhe ueb-portali për karrierë në hapësirën e përbashkët hulumtuese janë vetëm disa prej nismave që i zvogëlojnë pengesat ndaj lëvizshmërisë, e përkrahin qarkullimin shkencëtarëve dhe hulumtuesve, si dhe kthimin e tyre në vendin-amë (a.q. brain circulation ose qarkullim i trurit).

Nga ana tjetër, përvojat e deritashme prej dy zgerimeve të fundit të BE-së tregojnë që lëvizshmëria e punës ka karakter kohor. Shumë emigrantë pas një kohe kthehen në shtëpi, me përvojë më të madhe të punës, aftësi dhe shkathtësi, si dhe me kontakte ndërkombëtare, që mund të jetë shumë e dobishme në zhvillimin e vendit-amë, e a.q. brain gain ose përfitimi i trurit. Përveç kësaj, përforcimi ekonomik në rastin e Spanjës dhe Portugalisë, pas anëtarësimit në BE, e ka motivuar edhe migracionin e kundërt kur forca e punës kthehet në shtetet-amë.

104 Për një kohë të gjatë, Maqedonia ka problem me shkallën e lartë të papunësisë. Si do të ndikojë kjo në afrimin tonë në bashkimin Evropian?

Deri në anëtarësimin në BE, Maqedonia duhet të realizojë reforma të gjëra, me të cilat krijohet ekonomia funksionale e tregut, që do të jetë e aftë ta mbajë presionin konkurrent të tregut evropian. Për ta plotësuar këtë kriter ekonomik të anëtarësisë, që njëherazi është edhe kusht për mbijetesë në ekonominë e globalizuar, Maqedonia mes tjerash duhet të krijojë treg funksional, fleksibil dhe të përshtatshëm të punës. Kjo do të thotë që Maqedonia duhet ta reformojë legjislacionin e punës, ta inkurajojë punësimin në mënyrë aktive me masa të ndryshme, të investojë më shumë në sistemin arsimor, në hulumtim dhe zhvillim, ta modernizojë sistemin e mbrojtjes sociale, ta promovojë konceptin e mësimin të përjetshëm... Megjithatë, gjeneratori themelor dhe kryesor i vendeve të reja të punës janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, posaçërisht mikro-ndërmarrjet. Së këndejmi, për të ndikuar në zvogëlimin e papunësisë në mënyrë afatgjate, duhet të punohet për krijimin e klimës afariste, të volitshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Klima e volitshme afariste në radhë të parë do të thotë sundim të të drejtës, mbrojtje të pronësisë private dhe intelektuale, si dhe sigurimin e qasjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ndaj mjeteve financiare me kushte të volitshme.

105 A mund t'i ndihmojë BE-ja Republikës së Maqedonisë në zgjidhjen e problemit të papunësisë?

Po. Pas marrjes së statusit të kandidatit, Republika e Maqedonisë ka qasje në (1) Programin Progres, (2) Instrumentin për ndihmë para-anëtarësim IPA - komponenta IV për zhvillimin e resurseve njerëzore ose (3) Programin për mësim të përjetshëm LLL, si dhe (4) Programin për konkurrencë dhe inovacion.

Pas integrimit të Maqedonisë në BE do të hapen fondet strukturore evropiane, me instrumente tjera të ndihmës dhe përkrahjes. Vetëm prej nesh varet a do t'i shfrytëzojë Maqedonia mjetet financiare në dispozicion dhe në çfarë mase do të ndodh kjo. Përvoja nga dy zgjerimet e fundit të BE-së tregon që papunësia në vendet e reja anëtare jo vetëm që nuk është rritur pas anëtarësimin, por vazhdimisht është zvogëluar.

106 A do të sjellë anëtarësimi në BE hapje të vendeve të reja të punës?

Po. Me anëtarësimin në BE, Maqedonia do të bëhet pjesë e tregut të përbashkët, me rreth 480 milionë konsumatorë. Anulimi i doganave dhe pengesave tjera tregtare do të krijojë më shumë mundësi punësimi, veçanërisht në industrinë e orientuara drejt eksportit. Konkurrenca e tregut evropian e stimulon modernizimin e punës, kurse qasja ndaj kapitalit të lirë, teknologjisë dhe diturisë së re e rrit konkurrencën e kompanive. Nga ana tjetër, nevoja për dituri dhe aftësi specifike për përfshirjen e kompanive vendase në tregun evropian

do të rezultojë me rritje të punësimit tek të rinjtë dhe kuadrit me kualifikim të lartë. Në fund, stabiliteti ekonomik dhe politik i Maqedonisë së anëtare e BE-së do të ndikojë në atraktivitetin e vendit për investimet e huaja dhe do ta nxisë investimin vendas. Sinergjia e këtyre proceseve patjetër do të rezultojë me rritje të punësimit dhe rënie të papunësisë në Maqedoni.

107 Çka bën BE-ja në fushën e mbrojtjes sociale?

Politika sociale, si edhe politika e punësimit, nuk është ingjercencë ekskluzive e BE-së, por kryesisht përgjegjësi e shteteve-anëtare. Prapëseprapë, duke u nisur nga qëllimi i saj për “promovimin e zhvillimit ekonomik harmonik, të balancuar dhe të qëndrueshëm, nivelin e lartë të punësimit dhe mbrojtjes sociale, [...] nivelin e lartë të punësimit dhe mbrojtjes sociale, ngritjen e standardit jetësor dhe cilësisë së jetës, kohezionin ekonomik dhe social dhe solidaritetin mes shteteve-anëtare” BE përkrah disa aktivitete në fushën e mbrojtjes sociale. Për shembull, BE definojnë disa standarde minimale dhe të drejta të mbrojtjes sociale, që duhet të sigurohen në të gjitha shtetet-anëtare - ato mund të miratojnë vetëm rregulla dhe rregullativa për mbrojtje sociale, të cilat do të jenë më të mëdha/përfshirëse në nivelin minimal të përcaktuar nga BE, por jo më poshtë.

Më tej, çdo anëtar mund t'i shfrytëzojë edhe mjetet e Fondit social evropian ose Fondit evropian për përshtatjes së globalizimit të programeve të ndryshme në fushën e politikës sociale, sipas prioriteteve të përcaktuara nga BE-ja.

108 Si përgatitet Republika e Maqedonisë në këtë fushë, për anëtarësim në BE?

Për t'u përfshirë në BE, Maqedonia duhet të plotësojë disa kërkesa të legjislacionit të BE-së në planin e mbrojtjes sociale, në radhë të parë kërkesave për politikën sociale. Bëhet fjalë për inkorporim të standardeve minimale në legjislacionin e punës, mbrojtjen gjatë punës dhe sigurinë në vendin e punës, barazinë gjinore, masat e luftës kundër diskriminimit në bazë etnike, fetare ose religjioze, të moshës ose orientimit seksual ose personave me pengesa në zhvillim, si dhe masat për promovimin e dialogut social, mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale.

109 Çka është Strategjia evropiane për punësim - më shumë vende pune dhe vende më të mira për të gjithë?

Në fillimin e viteve '90 të shekullit të kaluar, të gjitha shtetet-anëtare të BE-së janë ballafaquar me problemin e papunësisë. Pa dallim nga zhvillimi ekonomik pozitiv, niveli i punësimit ka qenë shumë më i ulët nga niveli tek konkurrentët kryesorë në BE. Numri i të papunësuarve në periudhë afatgjate ka qenë i madh, njëjtë edhe me personat që kanë kërkuar punë kohë më të gjatë. Femrat, të rinjtë, personat e moshuar, pakicat etnike dhe personat me hendikep kanë pasur shumë vështirësi në tregun e forcës së punës. Duke e kuptuar peshën e problemit, në fund të shekullit të kaluar, Komisioni Evropian e ka promovuar Strategjinë evropiane për

punësim, me qëllim të krijimit të më shumë vendeve të punës, që do të jenë më të qëndrueshme, si dhe krijimit të vendeve të punës për grupet me më pak shanse në tregun e punës. Qëllimet themelore janë realizuar nga Strategjia, duke i bazuar në 4 shtyllat themelore: puna, sipërmarrësia, përshtatja dhe mundësitë e barabarta, duke e shfrytëzuar përkrahjen financiare nga Fondi social evropian. Ndonëse rritja e numrit të të punësuarve dhe zvogëlimi i % të të papunësuarve nuk mund t'i përshkruhet vetëm Strategjisë për punësim, Strategjia sot konsiderohet si rrëfim i suksesshëm evropian.

110 Çka parasheh Strategjia e Lisbonës për zhvillim dhe vendet e punës?

Në Samitin e Lisbonës në vitin 2000, Bashkimi Evropian ka përcaktuar një qëllim të ri dhe ambicioz strategjik: deri në 2010, BE të bëhet ekonomia më konkurrense dhe më dinamike në botë, e bazuar në dituri, të jetë e aftë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe të ketë më shumë vende pune më të mira, me kohezion të posaçëm social. Pesë vite më vonë, BE edhe më tej ballafaqohet me probleme serioze strukturore, me popullatën e moshuar, si dhe me rënien e treguesve ekonomikë. Për këtë arsye, Komisioni e ka propozuar revizionin e Strategjisë, me qëllim që fokusi të vendoset në përpjekjet për arritjen e dy qëllimeve kryesore: sigurimin e rritjes më të fuqishme dhe të vazhdueshme dhe hapjen e më shumë vendeve të punës, që do të jenë më të mira. BE i realizon këto qëllime përmes aktiviteteve në tre fusha: BE si vend më atraktiv për investime dhe punë, investim në dituri dhe inovacionet për zhvillim dhe krijim të më tepër vendeve të punës, që do të jenë më të mira. Qëllimet finale të strategjisë - rritja e nivelit mesatar të punësimit në BE (deri në

70%), rritja e përqindjes së femrave të punësuar (në 60%) dhe në 50% për personat e punësuar - me theks të veçantë për të rinjtë, personat e papunësuar në periudhë më të gjatë dhe grupet tjera të lëndueshme, si dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës për zvogëlimin e joaktivitetit të popullatës.

111 Çfarë mundësi kanë të rinjtë evropianë, për dallim nga prindërit e tyre?

Gjeneratat e reja të evropianëve mund të udhëtojnë, shoqërohen, mësojnë ose punojnë lirish në cilindo shtet-anëtar të Bashkimit Evropian, pavarësisht nga shteti ku janë lindur, gjuha që e flasin ose vendi prej ku vijnë.

112 Si mund të marr informata nëse dëshiroj të jetoj, udhëtoj, vizitoj, bëj punë vullnetare ose punoj në ndonjë shtet-anëtar të BE-së?

Të rinjtë nga Evropa që dëshirojnë të udhëtojnë, mësojnë, studiojnë, punojnë dhe jetojnë në cilindo vend të BE-së, mund t'i marrin të gjitha informatat, këshillat ose përgjigjet përmes Portalit për të rinj <http://europa.eu/youth/index.cfm>. Përveç kësaj, të rinjtë mund të marrin pjesë në diskutimet on-line ose të marrin përgjigje për ndonjë pyetje të caktuar përmes portalit. Qëllimi i portalit është të përforcohet pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike.

113 Çka i mundëson Bashkimi Evropian të rinjve?

Falë Programit të bashkësive për të rinjtë, të rinjtë e Bashkimit Evropian mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën kulturore dhe sociale të BE-së. Falë nismave të ndryshme dhe gatishmërisë së BE-së, si dhe Programit të bashkësive për të rinjtë, ata mund të marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes në kuadër të BE-së.

114 A do të pranohen kualifikimet dhe aftësitë e mia nëse dëshiroj ta vazhdoj shkollimin ose të punoj në ndonjë shtet tjetër evropian?

Për ta mundësuar vlerësimin adekuat të kualifikimeve dhe aftësive të fituara në kuadër të Evropës (shtetet BE/EFTA/EEA dhe shtetet-kandidate për anëtarësim), që nga viti 2004 ekziston EUROPASS, shërbim i siguruar përmes rrjetit të qendrave nacionale dhe internet portalit. Europass përbëhet prej pesë dokumenteve: Europass curriculum vitae (CV) dhe Europass Language Passport (që plotësohet nga personat e interesuar), Europass Certificate Supplement, Europass Diploma Supplement dhe Europass Mobility (që plotësohen dhe lëshohen nga organizatat kompetente). Është interesante që në portalin Europass plotësohen rreth 3.000 CV çdo ditë.

115 Çka është programi “Të rinjtë në aksion”?

“Të rinjtë në aksion” është program i BE-së për të rinjtë e moshës 15-28 vjeçare (në disa raste 13-30), që e synon kontributin drejt rritjes së ndjenjës për shtetësi aktive, solidaritet dhe tolerancë mes të rinjve, si dhe përfshirjen e tyre në procesin e krijimit të ardhmërisë së BE-së.

Programi dedikohet për të gjithë të rinjtë, pavarësisht arsimit të tyre, origjinës sociale ose kulturore. Përmes programit tentohet të arrihet lëvizshmëria më e madhe dhe shoqërimi brenda dhe jashtë BE-së, të rritet dialogu ndërkulturor dhe të përmirësohen aftësitë dhe kualifikimet e të rinjve përmes mësimi joformal.

Me buxhet prej 885 milionë eurove për periudhë shtatëvjeçare (2007-2013), programi mbështet aktivitetet e shumta rinore, përmes pesë aksioneve:

- ▶ “Të rinjtë për Evropën” (përfshin këmbime rinore, shoqërimin e të rinjve nga shtetet e ndryshme, pjesëmarrjen e të rinjve në proceset demokratike përmes projekteve dhe nismave tjera rinore);
- ▶ Shërbimi vullnetar evropian (pjesëmarrja e të rinjve në aktivitetet vullnetare brenda ose jashtë BE-së);
- ▶ Të rinjtë në botë (trajnimi, këmbimi i praktikave të mira dhe formave tjera të bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve fqinje të BE-së ose vendeve tjera të botës);
- ▶ Sistemi për përkrahje rinore (mes tjerash, përkrahja e Forumit evropian rinor);
- ▶ Përkrahja e bashkëpunimit evropian në fushën rinore (bashkëpunimi me të rinjtë, seminarët, këmbimi i përvojave dhe diturisë në fushat e lidhura me të rinjtë, si dhe bashkëpunimi i organizatave ndërkombëtare që punojnë në projekte për të rinjtë).

Programi është i hapur për të rinjtë e BE-së, Islandës, Lihneshtajnit, Norvegjisë, Turqisë, vendeve fqinje të BE-së (shtetet e Evropës juglindore, Evropës lindore dhe Kaukazit, shtetet e Mesdheut dhe shtetet tjera partnere nga bota).

116 A do të sjell ndryshime në kulturën politike anëtarësimi i shtetit në BE?

Politika kulturore është një prej fushave të cilat BE-ja ia ka lënë shteteve-anëtare që t'i rregullojnë vetë, përfshirë edhe formulimin e politikave kulturore dhe vendimeve për financimin e kulturës. Megjithatë, kultura, si edhe sektorët tjerë, përfshihen në shumë masa horizontale dhe do të nevojitet përshtatje ndaj standardeve evropiane për t'i mundësuar artistëve nga Maqedonia të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në hapësirën evropiane kulturore. Aderimi në BE do të hap mundësi për pjesëmarrje në projektet e përbashkëta evropiane, me çka do të nxiten artistët dhe institucionet në krijimin e veprave për gëzimin e publikut vendas.

117 A kanë mundësi njerëzit që punojnë në kulturë dhe institucionet kulturore në Republikën e Maqedonisë t'i shfrytëzojnë përparësitë e fondeve të BE-së?

Njerëzit që punojnë në kulturë dhe institucionet kulturore në të gjitha shtetet-anëtare të BE-së, në shtetet e Zonës ekonomike evropiane, shtetet-kandidate për BE dhe shtetet tjera të Ballkanit mund

t'i shfrytëzojnë përfitimet e programit “Kultura 2007-2013”. Programi e synon promovimin e lëvizshmërisë transnacionale të njerëzve që punojnë në kulturë, nxitjen e qarkullimit transnacional të veprave dhe prodhimeve artistike, si dhe nxitjen e dialogut ndërkulturor.

118 A do të bëhet Shkupi “Kryeqytet evropian i kulturës” dhe kur do të ndodh kjo?

Programi “Kulturë” menaxhon me aksionin për zgjedhjen e “kryeqytetit evropian të kulturës”. Programi ka filluar në vitin 1985 me Athinën si kryeqyteti i parë i kulturës në Evropë. Sivjet, në 2009, kryeqyteti evropian i kulturës është Vilnusi në Lituanë dhe Linzi në Austri. Tashmë njihen kryeqytetet evropiane kulturore deri në 2019 (qytetet nga Italia dhe Bullgaria). Qytetet e Republikës së Maqedonisë duhet ta presin së pari anëtarësimin e vendit në BE për ta fituar mundësinë e zgjedhjes si kryeqytet evropian i kulturës.

119 Si do ta nxisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë ruajtjen e identitetit nacional maqedonas?

Që nga fillimi i procesit të integrimit, shtetet evropiane kanë qenë të vetëdijshme që integrimi ekonomik dhe politik duhet të sjell njohje më të madhe të dallimeve dhe të mos krijohet “mbikultura” e re evropiane. Një prej parimeve themelore të BE-së është barabarësia e dallimeve, parim që do ta mbrojë edhe Republika e Maqedonisë pas anëtarësimit të plotë në BE.

BARAZIA GJINORE

123 A është barazia gjinore çështje “femërore”?

Për një kohë të gjatë, politikanët dhe ata që i miratojnë vendimet, madje edhe femrat, kanë besuar që barazia gjinore është kryesisht çështje “femërore”. Por, këto dy koncepte dallojnë në esencë, sipas problemit që e trajtojnë, qëllimit të synuar dhe në aspekt të strategjisë së aplikuar. Tabela në vijim i ilustron dallimet mes dy koncepteve.

	Çështja e femrave	Politika gjinore
Fokusi	Femrat	Marrëdhëniet mes femrave dhe meshkujve në shoqëri
Problemi	Përfshirja e femrave në shoqëri	Kushtet e pabarabarta që nuk e lejojnë pjesëmarrjen e plotë të femrave dhe që janë pengesë për zhvillim të barabartë dhe proporcional
Qëllimi	Zhvillimi shoqëror më efikas dhe më efektiv	Zhvillimi i barabartë, ku femrat dhe meshkujt vendosin së bashku, e ndajnë pushtetin, mundësitë dhe burimet

Zgjidhja	Integrimi i femrave në struktura	Transformimi i marrëdhënieve dhe strukturave të pabarabarta dhe përforcimi i femrave që janë më pak të privileguara
Strategjia	Projektet që lidhen vetëm me femrat - për rritjen e prodhueshmërisë, të ardhurave dhe aftësisë për menaxhimin shtëpiak	Identifikimi dhe zgjidhja e nevojave strategjike praktike, të përcaktuara bashkërisht nga femrat dhe meshkujt, në drejtim të përmirësimit të kushteve të tyre

124 A mund të arrihet barazia gjinore me ligje?

Zhvillimi i politikës gjinore në Bashkimin Evropian ka kaluar disa faza. Që nga viti 1957, me Traktatin e Romës, trajtimi i barabartë i femrave dhe meshkujve konsiderohet si parim themelor i Bashkimit Evropian. Megjithatë, rezultatet ngecin. Vitet '70 në BE njihen si periudhë e të drejtave individuale për barabarësi. Në vitin 1975 është miratuar direktiva e parë, pastaj vijojnë edhe shumë tjera. Ligjet janë treguar efektive në luftën kundër diskriminimit të tepruar, por nuk mjaftojnë për arritjen e barabarësisë. Ato bazohen në tezën që femrat dhe meshkujt duhet të trajtohen njëjtë, duke harruar që femrat dhe meshkujt nuk nisen nga pikënisja e njëjtë. Është bërë e qartë që politikat neutrale nuk do ta sjellin rezultatin e dëshiruar. Në tabelën 2 ceken direktivat më të rëndësishme që aplikohen në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian.

125 A arrihet barazia gjinore përmes diskriminimit pozitiv?

Në vitet '80 janë bërë përpjekje për ta zgjidhur problemin e femrave me ndihmën e aksioneve konkrete pozitive, të njohura këtu si "diskriminim pozitiv" ose kuota. Kjo e ka shënuar fillimin e politikave të orientuara drejt femrave. Këto politika kryesisht janë marrë me atë "që i mungon" femrave - duke u nisur nga supozimi që problemi është tek femrat, kështu që femrat duhet ndryshuar. Diskriminimi pozitiv është treguar si zgjidhje e pjesërishme, në dobi të femrave. Kuotat i kanë përgatitur femrat të funksionojnë në shoqëri ku dominon kultura e meshkujve, por nuk e ka sfiduar atë. Hapi i ardhshëm ka qenë një hap logjik - Bashkimi Evropian e ka ndryshuar qasjen dhe në vitin 1966 e ka futur të a.q. "inkorporim të dimensionit gjinor në rrjedhat kryesore shoqërore" (gender-mainstreaming).

126 Çka është inkorporimi i dimensionit gjinor në rrjedhat kryesore shoqërore" (gender-mainstreaming)?

Kjo qasje bazohet në faktin që strukturat ekzistuese nuk janë neutrale në aspektin gjinor dhe në një mënyrë suptile, e vendosin një rëndësi ose gjininë tjetër në pozitë më të volitshme. Është treguar që në politikat e miratuara dhe zbatuara nevojitet inkorporimi i aspekteve të ndryshme (mosha, prejardhja etnike, personat me nevoja të posaçme, orientimi seksual, etj), meqë ato ndikojnë në mundësinë që personi të garojë në baza të barabarta. Ky koncept nuk e nënkupton vetëm përmirësimin e qasjes ose balancimin e statistikës, nuk është as akuzim i të tjerëve për pabarazinë, nuk kërkon arsyetime për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe projekteve në dobi ekskluzive të femrave. Me inkorporimin e dimensionit femëror në të gjitha rrjedhat shoqërore bëhet e qartë që gjinia ka rol themelor në organizimin shoqëror dhe ndikon në jetën tonë, që nga momenti i lindjes. Ekzistojnë dallime në jetën e femrave dhe meshkujve, për këtë arsye ata kanë dallime, përvoja dhe prioritete të ndryshme. Procesi është proaktiv dhe orientohet drejt zvogëlimit të varfërisë, nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe përforcimit të qytetarisë. Logjika ekonomike tregon që femrat janë aktivë sa edhe meshkujt, kështu që duhet ta shfrytëzojnë forcën produktive të punës në nivel 100%.

127 A kanë femrat në BE rroga më të ulëta se meshkujt?

Bashkimi Evropian nuk është ideal, ndonëse ka tendencë të përmirësimit në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Vazhdimisht rritet numri i femrave që punojnë, kurse prej vitit 2000, pothuajse 3/4 e vendeve të reja të punës (në miliona) në Evropë, plotësohen nga femrat. Tani, femrat tregojnë rezultate më të mira në shkollë, krahasuar me meshkujt dhe janë 59% e studentëve të diplomuar në BE. Por, pa dallim nga përparimi i shënuar, femrat edhe më tej fitojnë 15% më pak se meshkujt. Femrat edhe më tej mbesin pakicë në politikë dhe ka shumë pak femra në pozita udhëheqëse menaxhuese. Për këto arsye, BE punon me tërë forcën për eliminimin e diskriminimit, si mënyrë e vetme për arritjen e barazisë gjinore. Qëllimet kryesore që duhet arritur deri në vitin 2010 janë: thyerja e stereotipave dhe arritja e pavarësisë gjinore të femrave, që edhe ato të kenë mundësi pune, të realizojnë të hyra vetanake dhe të kenë të drejta të barabarta të beneficioneve. BE ka krijuar rrjet të femrave të përfshira në politikë, me qëllim të përshpejtimit të qasjes së femrave ndaj pushtetit.

128 A janë meshkujt sipërmarrës më të mirë se femrat?

Numri i meshkujve që kanë kompanitë e tyre në Evropë është shumë më i madh se numri i femrave. Vetëm rreth 8% e forcës punuese femërore janë sipërmarrës, krahasuar me 16% meshkuj. Por, kjo nuk do të thotë që meshkujt janë afarist më të suksesshëm se femrat. Shpesh herë, femrat ballafaqohen me probleme më të mëdha në qasjen ndaj financave për fillimin ose zgjerimin e biznesit të tyre. Të dhënat e fundit tregojnë që numri i

meshkujve të vetë-punësuar dhe që punësojnë të tjerë është tre herë më i madh se femrat. BE beson që aftësitë sipërmarrëse të femrave mund ta përforcojnë prosperitetin evropian. Në vitin 2004 është realizuar nisma për rritjen e numrit të bizneseve të reja të femrave. Rrjeti evropian për promovimin e sipërmarrësisë të femrave ka anëtarësinë e saj në 30 shtete evropiane, duke dhënë këshilla dhe përkrahje dhe duke e lehtësuar kontaktimin e femrave-sipërmarrëse, me çka i ndihmon në krijimin e profilit të tyre dhe zgjerimin e bizneseve që i kanë.

129 Si trajtohet dhuna kundër femrave në Bashkimin Evropian?

Dhuna ndaj femrës, në cilëndo formë, është e papranueshme. Prapëseprapë, shumë gra dhe femra në Evropë edhe më tej jetojnë nën hijen e agresionit ose eksploatimit. Ata janë viktimat të dhunës në familje ose keqpërdorimit seksual, trafikimit me genie njerëzore ose prostitucionit të dhunshëm, si dhe viktimat të frikës dhe presionit, me çka rrezikohen të drejtat themelore të lirisë, dinjitetit dhe sigurisë. Bashkimi Evropian e lufton rrënjën e trafikimit të qenieve njerëzore, duke i arrestuar bandat kriminele që jetojnë nga shfrytëzimi i femrave. Kjo arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar të policisë dhe gjykatësve, me ndihmën e këmbimeve të sofistikuar të informatave të zbulimit. Femrat bëhen më pak të lëndueshme ndaj eksploatimit, nëse paralelisht me eksploatimin luftohet edhe varfëria, posaçërisht në shtetet në zhvillim.

130 A kanë shtetet me pushim më të gjatë për lindje më shumë kuptim për nevojat e femrave?

Mungesat e gjata të lindjes nuk e nënkuptojnë edhe kuptimin më të madh për nevojat e femrave. Përkundrazi, ndonjëherë kjo është mënyrë suptile e inkurajimit të femrave të qëndrojnë në shtëpi dhe të kujdesen për fëmijët, në vend që ta krijojnë karrierën profesionale. Kombinimi i detyrave të punës dhe kujdesi për fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes është çdoherë e më e rëndësishme për femrat, si dhe për meshkujt, kohëve të fundit. Por, ndarja e detyrave shtëpiake edhe më tej mbetet e pabarabartë dhe femrat e kanë më vështirë ta krijojnë karrierën e tyre. Vetëm 56% e femrave me fëmijë të vegjël punojnë në BE, krahasuar me 91%

të meshkujve. BE përpiqet të krijojë baraspeshë më të mirë gjinore mes jetës profesionale, private dhe familjare, për t'i mundësuar të gjithëve ta planifikojnë lindjen e fëmijëve ose të kujdesen për anëtarët tjerë të familjes, pa përjetuar stres dhe pa u frikuar nga varfëria. Kjo është arsyeja pse ekzistojnë ligjet për mungesën e prindërve, orari i shkurtuar i punës dhe mbrojtja e shtatzënave dhe lehonave në vendin e punës. BE ndërmerr masa për rritjen e mungesës së paguar për të dy prindërit (jo vetëm femrës), si dhe për inkorporimin e orarit fleksibil të punës, me qëllim të arritjes së baraspeshës më të mirë mes obligimeve profesionale dhe familjare.

Direktiva për	Nr.i direktivës	Qëllimi
Rroga e barabartë	75/117/EES - OJL 45 19.2.1975	Eliminimi i diskriminimit gjinor në të gjitha aspektet e marrjes së rrogës
Trajtimi i barabartë	76/207/EES - OJL 39 14.2.1976	Eliminimi i diskriminimit gjinor - direkt dhe indirekt - dhe cilësdo lidhje me statusin civil dhe familjar në qasjen në punësim, trajnim, kushte të punës, avancim ose lëshim nga puna
Sigurimi social	79/7/EES - OJL 6 10.1.1979	Trajtimi i barabartë i femrave dhe meshkujve në mbrojtjen ligjore gjatë sëmundjes, invaliditetit, moshës, fatkeqësive në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe në rast të papunësisë
Sigurimi social profesional	86/378/EES - OJ L 225, 12.8.1986	Aplikimi i trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në skemat sociale profesionale të sigurisë. E ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1996.
Vetë-punësimi	86/613/EES - OJ L 359, 19.12.1986	Aplikimi i parimit të trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve për të vetë-punësuarit, përfshirë edhe bujqësinë dhe mbrojtjen e femrave të vetë-punësuar gjatë periudhës së shtatzënësisë dhe lehonisë
Punëtoret-shtatzëna	92/85/EES - OJ L 348, 28.11.1992	Aplikimi i masave minimale për përmirësimin e mbrojtjes dhe shëndetit në punë për femrat shtatzëna, lehonat dhe kujdestaret, përfshirë edhe të drejtën ligjore të pushimit të lindjes prej të paktën 14 javëve.

Mungesa e prindërve	96/34/ES - OJ L 145, 19.6.1996	Garantimi i të gjithë prindërve deri në moshën e caktuar të fëmijëve që përcaktohet nga shtetet-anëtare për të fituar të paktën 3 muaj mungesë të prindërve, si dhe për individët që mund të marrin kohë të lirë kur anëtari-vartës i familjes është i sëmurë ose lënduar
Obligimi i dëshmisë	97/80/ES - OJ L 14, 20.1.1998	Ndryshimi i sistemeve ligjore të shteteve-anëtare për obligimin e dëshimit për ndarjen më të barabartë, në rastet kur punëtorët ankohen nga diskriminimi seksual që ushtrohet nga punëdhënësit
Trajtimi i barabartë gjatë punësimit	2002/73/ES -OJ L 269, 5.10.2002	Plotësim esencial i Direktivës për trajtim të barabartë, jep përkufizime për diskriminimin indirekt, maltretimin dhe keqpërdorimin seksual, duke kërkuar nga shtetet-anëtare të krijojnë organe për barazi, me qëllim të promovimit, analizës, përcjelljes dhe përkrahjes së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve
Mallrat dhe shërbimet	2004/113/ES-OJL 373, 21.12.2004	Aplikimi i parimit të trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve për qasjen ndaj mallrave dhe shërbimeve të kapshme publike. Për herë të parë zgjerohet legjislacioni për barazi gjinore jashtë fushës së punësimit

TRAKTATI I LISBONËS

131 Çka ndodhi me Kushtetutën e Bashkimit Evropian dhe pse dallohet nga Traktati i Lisbonës?

Është ndryshuar emri - nga marrëveshja kushtetuese në traktat reformues. Pjesa më e madhe e përmbajtjes së draft-marrëveshjes kushtetuese është kopjuar, por struktura dhe forma e traktatit të ri është i ndryshuar në masë të madhe (i plotësuar dhe ndryshuar, por nuk është traktat i konsoliduar). Kjo do të thotë që ratifikimi mund të evitohet në shumë shtete-anëtare, meqë qëndrimi i qeverive është që bëhet fjalë për aspekte teknike.

132 Cilat do të jenë institucionet e BE-së?

Traktati reformues parasheh shtatë institucione të BE-së (tani janë pesë), kurse disa rrimërohen. Institucionet jepen në vijim: Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Komisioni Evropian, Gjyqi i të drejtës, Banka qendrore evropiane dhe Gjyqi i revizorëve. Këtu shihet që Këshilli Evropian ngrihet në nivel instituti, si dhe Banka qendrore evropiane, që më parë ka qenë hibrid mes institucionit dhe trupit të Bashkësisë Evropiane.

133 A do të zgjidhet Kryetari i BE-së pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës?

Do të zgjidhet Kryetari i Këshillit Evropian, me mandat prej 2,5 viteve dhe të drejtë për një rizgjedhje. Tani ka mbetur kryesia në rotacion për konfigurimet e ndryshme në Këshill (p.sh. drejtësi, bujqësi), përveç Këshillit për çështje të jashtme, që udhëhiqet nga Përfaqësuesi i lartë i BE-së për çështje të jashtme dhe politikë të sigurisë¹.

134 A do të ketë BE-ja Ministër për punë të jashtme?

Mbretëria e Bashkuar ka insistuar që titulli i këtij funksioni të jetë Përfaqësuesi i lartë i BE-së për çështje të jashtme dhe politikë të sigurisë, por kjo de facto është ministër i punëve të jashtme të BE-së. Personi në fjalë është nënkryetar i Komisionit Evropian dhe do të jetë përgjegjës për punët e jashtme dhe buxhetin (në disa miliardë) për çështjet e jashtme. Ai/ajo kryeson me Këshillin e BE-së për punë të jashtme. Ndonëse në disa fusha do të aplikohet shumica e kualifikuar për miratimin e vendimeve, në politikën e jashtme do të vazhdohet me votimin e njëzëshëm, ku të gjitha shtetet-anëtare

¹ Ndryshohet edhe titulli i Përfaqësuesit të lartë të BE-së për çështje të jashtme dhe politikë të sigurisë

kanë të drejtë për veto. Krijohet edhe Shërbimi për aksion të jashtëm të BE-së (shërbimi diplomatik).

135 Si do të duket sistemi i ri i votimit?

Sistemi i ri me shumicë të dyfishtë në Këshill (55% e shteteve-anëtare që kanë 65% të popullatës së BE-së) do të hyjë në fuqi në vitin 2014 me periudhë trevjeçare kalimtare. Për t'i evituar ngeçjet në traktat për këtë çështje, prolongimi deri në vitin 2017 është lëshim-kompromis për Poloninë. Shumica e kualifikuar do të aplikohet edhe në 51 fusha të politikës, kurse votimi i njëzëshëm do të aplikohet edhe më tej në politikën e jashtme, sigurinë sociale, politikën tatimore dhe kulturën. Mbretëria e Bashkuar ka fituar ndryshime për bashkëpunimin gjyqësor dhe policor.

136 Çka parasheh Traktati i Lisbonës për parlamentet nationale dhe Parlamentin Evropian?

Procedura e vendim-marrjes së përbashkët (Këshilli dhe Parlamenti) zgjerohet në fusha të reja, si që është drejtësia dhe punët e brendshme. Holanda ka insistuar që parlamentet nationale të fitojnë mekanizëm për paralajmërim të hershëm, me të cilin do të kenë mundësi të kundërshtimit të draft-legjislacionit të BE-së, për shkak të mosrespektimit të parimit të subsidiarititetit. Parlamenti Evropian e zgjedh Kryetarin e Komisionit Evropian me shumicë të thjeshtë, në propozim të Këshillit. Teoretikisht, kjo duhet të rezultojë me konkurrencë të orientimeve politike të Komisionit.

137 Çka do të ndodhë me Kartën e BE-së për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës?

Kjo kartë është e obligueshme, por teksti i Kartës nuk është pjesë e Traktatit. Në Mbretërinë e Bashkuar, gjyqet nuk do të mund të veprojnë sipas kartës, kurse Polonia ka imponuar deklaratë unilaterale që Karta nuk mund të ndikojë në ingjerenat e qeverisë nacionale për rregullimin e fushës së "moralit publik dhe të drejtës familjare" që thuhet se nuk ka vlefshmëri ligjore.

138 Çka ndodh me simbolet e BE-së?

Të gjitha simbolet dhe veçoritë shtetërore, si që është kushtetuta, flamuri, himni, motoja, etj përjashtohen me Traktatin. Federalistët evropianë e shohin këtë si dështim, por supozohet që në realitet kjo nuk do të ketë rëndësi të madhe.

139 A ka Bashkimi Evropian subjektivitet juridik ndërkombëtar?

Bashkimi Evropian ka fituar subjektivitet juridik dhe tani mund të hyjë në marrëdhënie juridike me shtetet tjera ose organizatat ndërkombëtare, të merr të drejta dhe obligime nga këto marrëdhënie (për shembull: nënshkrimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, qasja ndaj organizative ndërkombëtare, etj).

140 A është i pranueshëm bashkëpunimi i përforcuar në BE pas Traktatit të Lisbonës?

Mbështetet mundësia që nëntë ose më shumë shtete-anëtare të bashkëpunojnë më ngushtë në ndonjë fushë ose politikë të caktuar. Kështu është futur edhe euroja dhe është krijuar Zona Shengen për tregti të lirë. Rreziku i bashkëpunimit të forcuar mes disa shteteve është që kjo mund të rezultojë me skenarin e “Evropës me disa shpejtësi” (ose Evropës me rrahë koncentrikë), ku mund të ndodhë që disa shtete të integrohen më shumë se shtete tjera. Mbase kjo nuk është zgjidhja më e mirë, por megjithatë e eviton mundësinë e formimit të “Evropës me emëruesin më të vogël të përbashkët”.

141 A parasheh Traktati i Lisbonës politika të reja të përbashkëta?

Jepen udhëzime të reja për **energjetikën** (solidaritet) dhe nevojën për luftimin e **ndryshimeve klimatike**. Megjithatë, nuk barten injerenca të reja në nivel të Bashkimit Evropian.

142 Çka ndodh me politikën për konkurrencë?

Marrëveshja parasheh protokoll të ri dhe me obligim ligjor, ku ceket që tregu i brendshëm e përfshin sistemin me të cilin sigurohet mos-devijimi i konkurrencës. Të gjitha dispozitat paraprake nga fusha e konkurrencës mbeten edhe më tej.

143 A është politika e BE-së për zgjerim pjesë e këtij Traktati?

Parashihet që shtetet që aderojnë për anëtarësim në BE t'i promovojnë “vlerat” e BE-së. Artikulli i ri 1a i Dispozitave të përgjithshme të Traktatit i cek këto vlera². Arsyeja e deritashme (kapaciteti absorbues i BE-së) nuk ceket si kriter për anëtarësim. Në përgjithësi, traktati i ri reformues është i volitshëm për zgjerimet e ardhshme të BE-së, meqë shumë shtete do të sprovoheshin ta bllokojnë zgjerimin e mëtejshëm pa “marrëveshje tregu” duke u arsyetuar që institucionet e BE-së do të jenë të pafuqishme dhe jofunksionale. Ndonëse rruga e zgjerimit edhe më tej do të jetë me “kalldrëme”, pas procesit të ratifikimit do të mënjanohet një pengesë e rëndësishme.

² Neni 1 i Dispozitave të përgjithshme të Traktatit reformues të BE-së parasheh: BE bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, dinjitetit, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të të drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të drejtat e personale që i takojnë pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për shtetet-anëtare, në shoqëritë ku mbijeton pluralizmi, mos-diskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes meshkujve dhe femrave”.

144 Kur do të hyjë në fuqi Traktati i Lisbonës?

Traktati i Lisbonës është nënshkruar nga të gjitha shtetet-anëtare dhe aktualisht është në ratifikim e sipër. Procedura e ratifikimit nga shtetet-anëtare rrjedh sipas dispozitave të kushtetutave të tyre dhe kjo bëhet nga parlamentet nacionale të shteteve-anëtare, gjegjësisht nga qytetarët në referendum. Në referendumin e qershorit 2008, qytetarët e Republikës së Irlandës nuk e pranuan Traktatin e Lisbonës, që shkaktoi një krizë të vogël në BE për zgjerimin e mëtejshëm, si dhe për pranimin dhe zbatimin e Traktatit. Duke u ballafaquar me presionin e fuqishëm të opinionit publik të shteteve tjera anëtare dhe duke qenë e vetëdijshme për nevojën e reformave, në vitin 2009, Republika e Irlandës do të realizojë referendum tjetër, ku sipas hulumtimeve të mendimit publik pritet që qytetarët ta pranojnë Traktatin. Pas ratifikimit nga të gjitha shtetet-anëtare, Traktati mund të hyjë në fuqi dhe të fillohet me zbatim.



The following text is a placeholder for the main content of the page, which is currently blank.

CIP - Katalogizimi i publikimit

Biblioteka nacionale dhe universitare

"Sh. Kliment Ohridski" Shkup

341.171(4-672EU) (035)

Gjithçka që keni dashur të dini për Bashkimin Evropian/ - Shkup

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur Maqedoni,

2009. - 62 str., ilustr. : 20h20 sm..

ISBN 978-9989-185-98-4

a) Bashkimi Evropian - Doracakët





The following text is a placeholder for the main content of the page, which is currently blank.